

1 E enjte, 12 maj 2022

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 9.45

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëmëngjes.

7 Znj. Sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita të nderuar
9 Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-05, Prokurori i
10 Specializuar kundër Salih Mustafës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Në fillim të prezantojmë të pranishmit.

14 Për ZPS-në, shoh që keni të njëjtën përbërje të ekipit si
15 dje.

16 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E

18 mbajtëm shënim.

19 Për Mbrojtësen e Viktimave, e njëjta vlen?

20 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Po.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shoh

22 që dhe znj. Pues është e lidhur përmes platformës Zoom.

23 Edhe ekipi i Mbrojtjes ka të njëjtën përbërje?

24 Z. SHALA: [Përkthim] Po.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

1 z. Mustafa është i pranishëm në sallë. Dhe për procesverbalin,
2 ky proces zhvillohet përpara Trupit Gjykues numër 1.

3 Sot do të vijojmë me dëshminë e Dëshmitares së Mbrojtjes
4 1600, znj. Teuta Hadri. Por përpara kësaj, do të lëshoj një
5 sërë urdhrash gojarisht.

6 Pas kësaj, z. Avokat, do t'ju drejtohem i juve lidhur me
7 aspektin e përkthimit që lindi dje. Do t'jua jap juve fjalën.
8 Dhe pastaj do të fillojmë me pyetjet që do t'i bëjë Mbrojtësja
9 e Viktimave.

10 Urdhri i parë gojarisht i drejtohet Mbrojtjes.

11 Trupi Gjykues vëren se pas deklaratës pa betim të të
12 akuzuarit që është planifikuar të kryhet më datë 19 dhe 20
13 maj, pra javën e ardhshme, nuk do të ketë më dëshmitarë apo
14 provat e tjera të paraqiten gojarisht nga Mbrojtja.

15 Gjithashtu me anë të urdhrit gojarisht të datës 21 prill
16 2022, Trupi Gjykues ka përcaktuar të mërkurën 25 maj si afatin
17 kohor për palët dhe Mbrojtësen e Viktimave të paraqesin
18 kërkesat e tyre për të paraqitur prova materiale të përdorura
19 gjatë pyetjeve përkatëse që ua kanë bërë dëshmitarëve të
20 Mbrojtjes që kanë dëshmuar në muajt prill dhe maj të vitit
21 2022.

22 Krahas këtyre kërkesave, nëse do të ketë, nëse Mbrojtja
23 do të kërkojë pranimin e materialeve të tjera të cilat janë
24 përdorur gjatë pyetjeve të bëra dëshmitarëve që janë materiale
25 sipas Nenit 37 të ligjit apo materiale të tjera, duhet të

1 parashtrojë kërkesë për këtë qëllim gjithashtu brenda të
2 mërkurës, 25 maj 2022.

3 Pas këtij afati, Trupi Gjykues e mendon të përshtatshme
4 të përcaktojë të enjten, 26 maj 2022 si datën e synuar për të
5 mbyllur paraqitjen e provave nga Mbrojtja në përputhje me
6 rregullin 131 të Rregullores. Më 26 maj, Mbrojtja duhet të
7 dorëzojë njoftim me shkrim sipas rregullit 131 të Rregullores
8 përmes të cilit e informon Trupin Gjykues, ZPS-në dhe
9 Mbrojtësen e Viktimave se nuk do të ketë më dëshmitarë të
10 tjerë për t'u thirrur apo materiale të tjera provuese për të
11 paraqitur dhe do ta mbyll paraqitjen vet të provave.

12 Këtu mbyllet ky urdhër i parë gojarisht.

13 Urdhri i dytë gojarisht i drejtohet Mbrojtëses së
14 Viktimave.

15 Në pajtim me urdhrin gojor të datës 23 mars 2022 Trupi
16 Gjykues urdhëron Mbrojtësen e Viktimave të propozojë një apo
17 më shumë ekspertë për ta asistuar Trupin Gjykues në vlerësimin
18 shpërblimit financiar të dëmtimit, të dëmit material që
19 pretendohet se kanë pësuar viktimat e drejtpërdrejta. Trupi
20 Gjykues ka marrë parashtrimin e Mbrojtëses së Viktimave që
21 sugjeron emërimin e një eksperti që është parashtrimi i
22 protokolluar F392 më 21 prill 2002 si edhe parashtrimin përmes
23 të cilit Mbrojtësja e Viktimave na përcjell CV-në e ekspertit
24 të propozuar që është parashtrimi i protokolluar me numër
25 F397, 25 prill 2022.

1 Trupi Gjykues dëshiron që të marrë informacione të
2 mëtejshme nga Mbrojtësja e Viktimave sesa kohë parashikon që
3 do t'i nevojitet ekspertit të propozuar për të dorëzuar
4 raportin e tij nëse do të emërohet nga Trupi Gjykues. Trupi
5 Gjykues do të marrë këtë në konsideratë për të marrë vendim
6 nëse do të zhvillojë apo jo procese dëmshpërblimi pas
7 nxjerrjes së aktgjykimit në rast të shpalljes fajtor lidhur me
8 një apo më shumë prej akuzave të ngritura.

9 Duke pasur parasysh që Trupi Gjykues më përpara i ka
10 kërkuar Mbrojtëses së Viktimave që të dorëzojë parashtrime të
11 mëtejshme sesi synon të vijojë sa i takon vlerësimin të
12 shpërblimit financiar për dëmin që pretendohet se kanë pësuar
13 viktimat e tërthorta brenda të hënës, 23 maj 2022, Trupi
14 Gjykues i kërkon Mbrojtëses së Viktimave që të përfshijë në
15 këtë parashtrim edhe informacionin e lartpërmendur.

16 Këtu mbyllet ky urdhër i dytë gojarisht.

17 Urdhri i tretë dhe i fundit gojarisht ka të bëjë me
18 materialet që Mbrojtësja e Viktimave synon të përdorë me
19 pyetjet që do t'ia bëjë Dëshmitares 1600, siç u përmend dhe
20 dje.

21 Mbrojtësja e Viktimave i ka kërkuar leje Trupit Gjykues
22 përmes e-mailit të datës 10 maj 2022 të orës 16.03 minuta për
23 të përdorur materiale të nxjerra rishtazi në pyetjet që do
24 t'ia bëjë Dëshmitares. Materiali ka të bëjë me material të
25 nxjerrë më parë nga ZPS-ja po po atë ditë në orën 9 e 18

1 minuta me paketën e nxjerrjes numër 139, siç u përmend edhe
2 nga Mbrojtësja e Viktimave në kërkesën e saj.

3 Trupi Gjykses vëren se materialet e nxjerra rishtazi janë
4 versione të materialit të nxjerrë më përpara, pra përkthime në
5 gjuhën anglishte të pjesëve në gjuhën shqipe të librit të
6 shkruar nga Dëshmitarja e Mbrojtjes 1600. Trupi Gjykses
7 konstaton se ky material nuk është i gjatë dhe se mbrojtja e
8 ka pasur që më përpara në zotërim versionin origjinal të
9 dokumentit. Gjithashtu Mbrojtja nuk kundërshton përdorimin e
10 këtij materiali.

11 Rrjedhimisht Trupi Gjykses e lejon Mbrojtësen e Viktimave
12 ta përdorë këtë material gjatë pyetjeve që do ia bëjë
13 Dëshmitares 1600 në përputhje me paragrafin 31 të vendimit për
14 zhvillimin e procesit.

15 Këtu mbyllet urdhër i tretë gojarisht i Trupit Gjykses.

16 Mund të vijojmë tani me dëshminë e Dëshmitares së
17 Mbrojtjes 1600. Po përpara se të kërkojë që dëshmitarja të
18 futet në sallë, z. Avokat i Mbrojtjes dje në përfundim të
19 punimeve ngritët çështjen e një pasaktësie apo problemi në
20 përkthim.

21 Jua jap juve fjalën sepse nuk është se folëm për
22 përmbajtjen.

23 Ju lutem.

24 Z. SHALA: [Përkthim] Faleminderit, e nderuara Gjykatëse.

25 E lexoj në faqen shqip, faqja 28 e versionit në shqip të

1 deklaratës së Dëshmitares, rreshti 10 dhe 11. Në anglisht
2 është në faqen 25, rreshti 16 dhe 17.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po e
4 thoni deklarata e Dëshmitares, mos e keni fjalën për
5 deklaratën që ja ka dhënë Avokatit Mbrojtës apo ZPS-së?

6 Z. SHALA: [Përkthim] Deklaratën që a ka dhënë ZPS-së.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pjesa
8 e parë apo pjesa e dytë?

9 Z. SHALA: [Përkthim] Pjesa e dytë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pjesa
11 e dytë. Atëherë duhet të kalojmë tek pjesa e dytë, pra faqja e
12 fundit.

13 Z. SHALA: [Përkthim] Faqja 28, versioni shqip.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Versioni anglisht?

16 Z. SHALA: [Përkthim] Faqja 25, rreshti 16 dhe 17,
17 versioni në anglisht. Ndërsa në versionin shqip rreshtat 10
18 dhe 11.

19 Z. SHALA: [Përkthim] Unë do të lexoj në shqip dhe besoj
20 se përkthyesit do ta përkthejnë dhe kjo mund të krahasohet me
21 versionin në anglisht.

22 [Në shqip] "...jo e drejtë dhe kam besu se kjo Gjykatë
23 Speciale do të punon drejtë."

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 "...e padrejtë dhe besoj se kjo Gjykatë do të punojë me

1 drejtësi.”

2 A mund të na tregoni z. Avokat i Mbrojtjes cili rresht më
3 saktë apo cila pjesë e rreshtit u përkthye pikërisht tani.

4 Z. SHALA: [Përkthim] Rreshti 10 dhe 11.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
6 versionin shqip. Po në versionin anglisht?

7 Z. SHALA: [Përkthim] Më fal rreshtat 16 dhe 17.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Atëherë të lexoj edhe unë. Unë shoh që në rreshtin 16 shoh një
10 pikë dhe fillon një fjali e re. Dhe me “and” në anglisht
11 “dhe”.

12 “...dhe unë besoj se Dhoma e Specializuar nuk do të
13 punojë me drejtësi.”

14 Këtë deshët që të tregonit?

15 Z. SHALA: [Përkthim] Po.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
17 në përkthim thuhet:

18 “Unë besoj se kjo Gjykatë do të punojë me drejtësi.”

19 Z. SHALA: [Përkthim] Kjo ishte lidhur me këtë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
21 Prokurore, a ju jep kjo juve shtysë që ta ribëni pyetjen?

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Jo, sepse këtë tha dhe dëshmitarja
23 dhe e shpjegoi. Unë thjesht - edhe unë kur po e lexonte
24 fjalinë Avokati, unë do të sugjeroja që të lexohej e gjithë
25 fjalia të ishte e qartë për procesverbalin, po, jo nuk

1 mendoj se ka më nevojë tani.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Besoj
3 se kjo u sqarua tashmë.

4 Shumë mirë. Atëherë kërkoj që të shoqërohet dëshmitarja
5 për të hyrë në sallë. Pastaj do të vijojmë me dëshminë e saj.

6 Faleminderit znj. Asistente e Sallës.

7 [Dëshmitarja vijon dëshminë]

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Mirëdita, mirë se jeni kthyer znj. Hadri në Dhomat e
10 Specializuara. Më dëgjoni në rregull?

11 DËSHMITARJA: Po. [Në anglisht] Good morning.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Si
13 jeni?

14 DËSHMITARJA: Mirë, faleminderit.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Shpresoj të keni pasur mundësi të pushoni mbrëmë pas një dite
17 të lodhshme pune.

18 Shumë mirë. Ju rikujtoj se jeni ende nën betim për të
19 thënë të vërtetën. Do t'ia jap fjalën tani Mbrojtëses së
20 Viktimave, që e cila do t'ju bëjë disa pyetje.

21 Znj. Mbrojtëse e Viktimave, keni fjalën.

22 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
23 Gjykatëse.

24 DËSHMITARJA: TEUTA HADRI [Vijon]

25 Pyetje nga Mbrojtësja e Viktimave:

1 Py. Mirëmëngjes znj. Hadri.

2 Pë. Mirëmëngjes.

3 Py. Më quajnë Brechtje Vossenberq. Jam Bashkëmbrojtëse e
4 Viktimave pjesëmarrëse në këtë çështje gjyqësore. Dëshiroj
5 t'ju bëjë disa pyetje vijuese lidhur me kohën që ju e keni
6 kaluar në Zllash.

7 Pyetja e parë ka të bëjë lidhur me atë që na thatë dje,
8 lidhur me televizorin kur po qëndronit në Zllash. Na thatë se
9 më datë 17 patë televizor.

10 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Dhe për procesverbalin kjo
11 është diskutuar në faqen 4269 deri në 4271 të transkriptit. A
12 ju kujtohet që na e thatë këtë gjë dje?

13 Pë. Po.

14 Py. Po kjo do të thotë që kishte rrymë elektrike aty?

15 Pë. Po, në mëngjes po, pastaj s'di a ka pasë.

16 Py. Faleminderit.

17 Py. Do kaloj tek tema e dytë. Ka të bëjë me mbërritjen tuaj
18 në Zllash në prill të vitit '99. Unë do të bëj një përmbledhje
19 të gjërave që ju thatë dje, të disa prej gjërave dhe pastaj do
20 të bëj disa pyetje. Kështu që ju kërkoj pakëz durim.

21 Dje në sallë na thatë se udhëtuat për në Zllash më 16
22 prill '99 dhe në pjesën e fundit të udhëtimit dy ushtarë ju
23 çuan me automjet, më veturë në një vend që ndodhej në Zllash.
24 Ishte një udhëtim 15-20 minuta me veturë. Dhe nga dëshmia juaj
25 e kuptoj që ju çuan në një tip kompleksi me disa shtëpi dhe na

1 thatë se kur shkua në oborr, kur dolët në oborr dolën dy gra
2 që t'ju mirëprisnin dhe ju çuan në një vend që ishte shtabi.

3 Siç na e shpjeguat dje, ky shtab ishte 10-20 metra larg
4 ndërtesës ku ju flinit apo qëndronit në Zllash gjatë ditëve që
5 qëndruat aty në prill.

6 Dhe është në faqen 4203, rreshtat 4 dhe 5 të
7 procesverbalit.

8 A është kështu? A është e saktë pra kjo përmbledhje që
9 bëra unë të disa prej gjërave që thatë ju dje?

10 Pë. Po, 10 deri në 15 apo 20 minuta me makinë.

11 Py. Mirë, në rregull, faleminderit.

12 Na thatë edhe diçka për pamjen e brendshme, si dukeshin
13 na e përshkruat brendinë e këtij shtabit dje. Dhe ajo që na
14 thatë - po ju citoj:

15 "Kishte tre, katër a pesë shkallë. Një korridor i ngushtë
16 dhe pastaj dy dhoma, një në të djathtë e një në të majtë."

17 Dhe thatë që ju hytë në dhomën në të majtë dhe se ishte
18 dhe po citoj:

19 "Ishte një dhomë e vogël. Dhoma nuk kishte asgjë. Kishte
20 vetëm ca dyshekë. Në dysheme kishte një si farë dollapi ashtu
21 dhe asgjë tjetër.

22 Dhe për procesverbalin kjo është në faqen 4190, rreshtat
23 1 dhe 2.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
25 Mbrojtëse e Viktimave, të flisni më ngadalë ju lutem.

1 ZNJ. VOSSENBERG: [Përkthim] Po, ku kërkoj ndjesë. I
2 kërkoj ndjesë dhe përkthyesve.
3 Py. Diçka tjetër që thatë për këtë dhomë për shtabin ishte
4 se:

5 "Në atë moment nuk ndodhej askush në shtab."

6 Është në faqen 4188, rreshti 18.

7 Pra këto na thatë juve dje për shtabin dhe për këtë
8 dhomën në të majtë. A e thashë saktë? Thjesht është
9 përmbledhje.

10 Pë. Po, ashtu.

11 Py. Dhe këtë e mbështesni dhe sot si dëshmi apo jo?

12 Pë. Po.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
14 Mbrojtëse e Viktimave, znj. Dëshmitare e ka dëshmuar këtë. Nuk
15 ka nevojë t'i thoni a e ka ndryshuar mendjen apo jo. Nuk mund
16 të bëni pyetje për të njëjtën gjë. Thjesht mund ta përdorni
17 për pyetje vijuese.

18 ZNJ. VOSSENBERG: [Përkthim] Në fakt e kam një pyetje
19 vijuese. Me lejen e Trupit Gjykues dëshiroj t'i tregoj
20 Dëshmitares disa pjesë nga libri që është dhe ditari për të
21 cilin folëm dje. Ju biseduat dje me ditarin tuaj të luftës, me
22 Prokuroren.

23 Është në faqen 4263 të transkriptit ky diskutim.

24 Përpara se të kaloj tek pyetja që kam dua që për
25 procesverbalin dua të konstatoj se për cilën datë është kjo

1 pjesë e ditarit. Se znj. Hadri ne nuk e kemi të gjithë librin.
2 Është faqja e parë që kemi ne është faqja 251 dhe aty s'ka
3 datë për atë pjesë të ditarit.

4 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Sekretares së Gjykatës i them
5 që është me numër DSM00242 deri në 246. Versioni anglisht
6 është faqja 251 pastaj në DSM00242. Ndërsa në versionin shqip
7 të librit e kemi në DSM00236 deri në 299, në faqen 251.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Mbrojtësja e Viktimave, arsyeja pse doni t'i nxirrni këto
10 ekstrakte, cila është?

11 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Faqja e parë, dua të kuptoj
12 se për cilën datë shkruhet në ditar, në atë pjesë. Pastaj ka
13 dhe diçka tjetër që dua të diskutoj në faqen tjetër po aty
14 s'ka datë dhe do të doja që të siguroheshim së pari se për
15 cilën datë bëhet fjalë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atë
17 do ta lejoj.

18 Znj. Sekretare, mund të vijoni.

19 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Nuk e di nëse është faqja
20 251. A e shihni në ekran?

21 Py. Po, në gjuhën shqipe, po, po.

22 Pë. Shumë mirë. A mund të na thoni se për cilën datë bëhet
23 fjalë? Për cilën datë keni shkruar këtu sepse kjo është e para
24 faqe që kemi ne dhe nuk është data këtu e shënuar. Dhe unë dua
25 që të futet në procesverbal dhe data së cilës i përket kjo

1 pjesë.

2 Pë. Po. Unë besoj se e ke lexu dhe deklaratën mbasi
3 Mbrojtësja e palës tjetër... E ke lexu edhe deklaratën time
4 para Avokatit Mbrojtës edhe parë trupës së ZPS-së atëherë. E
5 ke të shkruar në deklaratë shumë mirë. Edhe këtu shumë kujtë
6 është po edhe në deklaratë është e njëjtë. Kjo është data 16
7 kur unë kam shkuar jam hyrë në Zllash. Data 16 është. I ki ato, të
8 gjitha i ki edhe në deklaratë.

9 Pë. Absolutisht. Por nuk bëja dot lidhjen midis kësaj date
10 dhe këtij teksti në ditar. Tani e kemi. Faleminderit shumë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
12 Dëshmitare, nuk duhet të komentoni për pyetjet që jua bëjnë.
13 Mjafton të jetë një përgjigje. Sepse tek e fundit është një
14 provë që paraqitet para Trupit Gjykses. Asnjë koment se ç'kanë
15 apo çfarë nuk kanë.

16 Znj. Mbrojtëse e Viktimave, më lejoni që të them një gjë
17 për procesverbalin, në faqen 10,000 - më falni - 1016 [sipas
18 përkthimit] ne kishim mbivendosje.

19 Pra për procesverbalin unë thashë, nuk duhet ta pyesni
20 nëse e ka ndryshuar mendjen apo jo për të qenë të plotë.

21 Mund të vazhdoni tashti.

22 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Dëshiroj të kalojmë tani në
23 faqen tjetër të këtij dokumenti si në shqip ashtu edhe në
24 anglisht.

25 Py. Në pjesën e sipërme këtu shkruani për një ecje me makine

1 15-20 minuta. A është i njëjti transport kur ushtarët ju çuan
2 aty apo jo?

3 Pë. Po, po.

4 Py. Në ditar, ju shkruani se ju kanë çuar në Zllash. Shoferi
5 ju nxori nga vetura dhe ju përshkruani këtu ndërtesën ku ju
6 çuan. Dhe shkruani dhe po e citoj:

7 "Më çuan në një shtëpi njëkatëshe, tre a katër shkallë
8 mbi tokë, e ngjashme me shtëpitë e Drenicës. Kishte një
9 korridor të ngushtë dhe dy dhoma të ngushta jo më të mëdha se
10 tre me pesë metra. Në dhomën në të majtë të hyrjes ishte
11 dikush me flokë bisht kali i cili ishte ulur në një tryezë
12 përpara një kompjuteri."

13 A është kjo e njëjta ndërtesë që përshkruani këtu në
14 ditar me të njëjtën ndërtesë që keni përshkruar dje si shtabi.

15 Pë. Po.

16 Py. Mënyra sesi e përshkruani këtë dhomë në ditar është mjaft
17 e ndryshme nga ajo që na thatë për këtë dhomë dje. Mund ta
18 shpjegoni këtë dallim?

19 Pë. Nuk është e ndryshme, q'ashtu është qysh e thashë dje. Ju
20 si e keni kuptu, s'e di, q'ashtu është.

21 Py. Arsyeja pse e bëra këtë pyetje është se jua citova më
22 herët sot kur përshkruanit se çfarë kishte në atë dhomë në të
23 majtë. Dje në sallë ju këtu thatë se:

24 "Ishte një dhomë e vogël. Dhoma s'kishte asgjë. Kishte
25 vetëm disa dyshekë përdhe, pra në dysHEME. Një si farë dollapi

1 ashtu dhe asgjë tjetër.”

2 Ndërsa tani po të shikojmë këtë që keni shkruar në ditar
3 gjithsesi ishte një person me këto flokët bishtaleca, bisht
4 kali që ishte ulur në tavolinë pranë kompjuterit. Prandaj dhe
5 më lindi kjo pyetje.

6 Pë. Ky nuk ka qenë në dhomë, ka qenë në dhomën tjetër, në
7 anën tjetër, veç dera është pa. Nuk ka lidhje ky me dhomën ku
8 jam hi unë. Dhoma ka qenë ashtu si e kam përshkru edhe qysh e
9 kam fol dje. Dhomë e vogël, askush. Në anën, nga dritarja ajo
10 shpia vogël shihet dhoma tjetër. Nuk e kam shkru unë për me
11 ardhë në Gjykatë. E kam shkru si shkrintare si duhet, si e kam
12 pa me sy. Ashtu është qysh është, mirë është dhe këtu dhe kjo.

13 Nuk kam përkthim.

14 Py. Jo, jo. Unë thjesht po tregoja që po dëgjoja fundin,
15 pjesën e fundit të përkthimit që po shpjegonit. Pra ju po
16 thoni që dhoma në të cilën ju hytë ishte dhoma me këto
17 dyshekët, shiltet pra. Ndërsa tjetra, dhoma tjetër ishte me
18 këtë personin me bishtalec e me kompjuter.

19 Pë. Dhoma tjetër s'ka pasë lidhje me dhomën time, veç dera ka
20 qenë e hapur. Nuk ka pasë lidhje dhoma tjetër me dhomën time.
21 Aty s'kam hi unë në dhomën, kam hi vetëm në këtë dhomën dhe
22 kështu si është e përshkrume.

23 Py. Në rregull. Të kalojmë tani tek faqja 253 e ditarit. Këtu
24 flisni diçka më me shumë hollësi se çfarë kishte në dhomë apo
25 në njërën prej dhomave gjithsesi të kësaj ndërtese.

1 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Ju lutem, znj. Sekretare që
2 të kalojmë në faqen tjetër.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Atëherë është DSM00244, si në versionin shqip edhe në
5 versionin anglisht.

6 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Po. Faleminderit, e nderuar
7 Gjykatëse.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
9 duket se ka një vonesë teknike.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Faleminderit, znj. Sekretare.

12 Do presim paksa.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti është në
14 ekran tani.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Faleminderit, znj. Sekretare.

17 Znj. Mbrojtëse e Viktimave, mund të vazhdoni.

18 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Faleminderit.

19 Py. Në faqen 253, që shihni në ekran, flisni diçka më me
20 hollësi për dhomën që shkruani në ditar dhe shkruani:

21 "Përballë divanit ku isha ulur unë ishte një dollap me
22 lloj-lloj armësh, karikatorësh me fishekë, tre plumba të gjatë
23 diku 15cm ishin vendosur si reklamë në dollap. Në të djathtë
24 ishte dritarja, një tavolinë me një telefon satelitor dhe një
25 kompjuter."

1 Për cilën prej dy dhomave bëhet fjalë këtu? Se mua më
2 duket se është e njëjta dhomë që po përshkruanit në ditar më
3 përpara.

4 Pë. Unë këtu e kam përshkru si pjesë e librit. Ajo dollapi ka
5 pasë vetëm fishekët dhe arma ka qenë e komandantit e vjerun
6 aty - arma e komandantit kush ka qenë aty, që ka qenë. Ama
7 këtu janë vetëm do fishekë të vogjël kështu që kanë qenë aty
8 në dollap numër, si lloj ekspozite. Edhe kompjuteri ka qenë
9 portabël, ajo mbajtet nonjiherë e në atë dhomën tjetër. Po
10 kompjuteri ka qenë në dhomën tjetër, jo këtu ku unë isha.
11 Mandej ndërkohë ndoshta e kam pru unë, tash 20 vjet e kom
12 shkru këtë edhe unë s'e kam pa të arsyeshme në detale që kam
13 me ardhë këtu. E u ba ai kompjuteri prej asaj dhome me ju lodh
14 me kokë e në këtë dhomë. Tash na muj, fill s'janë konë detale
15 kompjuteri, u kthy prej kësaj dhome në këtë dhomë apo prej
16 ksaj dhome. Unë aty s'kom ndejt, nuk e di a i kanë mbart, po
17 portabël. Mu duk qysh qesharake s'e kom mendu që...

18 Py. Mirë. Faleminderit për shpjegimin. Thjesht jam e
19 interesuar të di është si dukej, si dukej ky shtabi, si ishte
20 pamja e këtij shtabi dhe si ishin dhomat në shtab. Ju po thoni
21 që në një nga dhomat nga një anë kishte dyshekë dhe dollapë
22 dhe në dyshekë - dhe në anën tjetër, më falni, ishte kjo
23 skrivania me një kompjuter portabël, një person me bisht,
24 dollap dhe kolltuk apo jo? Kështu është?

25 Pë. Kjo dhoma ku kam qenë unë, ju dyshekë po i thoni

1 dysheku, ne i thojmë "shilte" kështu shilte të vogla në formë
2 dysheku, jo dyshekë me u shtri. Edhe kanë qenë shilte dhe kjo
3 ka qenë ajo.

4 E në të ndamen tjetër te shtëpitë e vogla ai korridori
5 1m, shihet dhoma nga larg dhe aty ka qenë tjetërkush, ka qenë
6 ai personi që të thashë me bisht edhe kjo është ajo - me
7 bishtalek.

8 Py. Mirë pra. Për të qenë e qartë, po flasim për shtabin hë?

9 Pë. Për shtabin e kemi fjalën, po. Shtabi. Që ai ka qenë
10 shtabi jonë. Nuk kemi pasë garnizone ne, shtab, shtëpitë e
11 fshatarëve, e popullit dhe populli ka qenë i lidhun me UÇK-në,
12 se mos të ishte ai popull s'e kishin fitu luftën dhe i kanë
13 lëshu shtëpitë e veta, shtëpitë e fjetjes, e pushimit, me
14 shilte.

15 Py. Mirë. Në fakt e mora përgjigjen e pyetjes sime, pyetjes
16 që kisha.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
18 mua nuk është e qartë tani ajo dhoma me ato shiltet. Çfarë
19 bëhej tek dhoma me shilte në shtab? Për çfarë ishte kjo dhoma
20 me shilte në shtab. Për çfarë ishte kjo dhoma me shilte në
21 shtab, a mund t'ia shpjegoni Trupit Gjykues ju lutem?

22 DËSHMITARJA: Dhoma me shilte - ne nuk kishim lluks si
23 karriga, tavolina. Populli shqiptar ato shilte i përdor me u
24 ul. Ato kanë qenë zona të varfra dhe shiltja është karrigë për
25 ta, dysheku që i thoni ju.

1 Nëse dikush prej juve ka qenë në Kosovë e kupton që
2 shiltja është shiltje, dysheku është dyshek. Kemi dy fjalë të
3 veçanta. Nuk janë karriga, po sfungjer, shilte.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
5 flinte njeri tek ajo dhoma me shilte?

6 DËSHMITARJA: Nuk e di unë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
8 përdorej si dhomë për fjetje?

9 DËSHMITARJA: Nuk e di unë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit. Mjafton për tani.

12 Mbrojtësja e Viktimave, fjala është për ju.

13 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Në fakt e njëjta gjë dhe për
14 mua. E mora përgjigjen e pyetjes.

15 Py. Faleminderit znj. Hadri.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
17 pra atëherë.

18 Znj. Dëshmitare, ne do vazhdojmë me pyetjet. Po shoh
19 Avokatin.

20 Z. Avokat, a keni pyetje për znj. Dëshmitare.

21 Z. SHALA: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sa
23 kohë mendoni se ju nevojitet?

24 Z. SHALA: [Përkthim] Kam tri pyetje, kështu që nuk e
25 parashikoj dot me saktësi kohën.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Atëherë vazhdoni me pyetjet shtesë që keni.

3 Znj. Dëshmitare, e ka Avokati radhën për t'ju bërë disa
4 pyetje.

5 Pyetje vijuese nga z. Shala:

6 Py. [Në shqip] Znj. Dëshmitare, dje në faqen 20 të
7 procesverbalit, rreshti 9, keni thënë që keni shku me vizitu
8 shkollën. A është e saktë kjo?

9 Pë. Po.

10 Py. Përveç faktit që keni shku me vizitu shkollën edhe që
11 keni ndejt në atë kompleksin ku e keni përshkru, a keni qenë
12 dikund tjetër në ndonjë pjesë tjetër të fshatit Zllash?

13 Pë. Jo.

14 Py. Faleminderit, znj. Dëshmitare.

15 Dje, gjatë parashtrimit të pyetjeve nga ana e
16 Prokurorisë, në faqen 59, në rreshtin 22 dhe 24, keni
17 përshkruar situatën kur jeni marrë me të plagosur. Gjatë
18 deklarimit tuaj, ju përmendët edhe dy emra. A ju kujtohen sot
19 q'ato dy emrat që i keni përmend si persona të plagosur ndaj
20 të cilëve, të cilëve iu keni ofru shërbim mjekësor, ndihmë.

21 Pë. Po.

22 Py. A mund të na i thoni?

23 Pë. Ka qenë Sokol Sopi kur kanë bo ofenzivën që i kanë pru
24 edhe Afrim Viti - Zhitia. A në shkollë a tjetër?

25 Thu aty Osman Gashi mbasi keni...

1 Z. SHALA: Jo, në rregull është znj. Dëshmitare.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
3 lutem, mos harroni rregullën e artë, numëroni deri në 5 para
4 se të përgjigjeni.

5 Z. SHALA: [Në shqip]

6 Py. Sokol Sopit dhe Afrim Vitisë, ju personalisht a i keni
7 ofru ndihmë mjekësore?

8 Pë. Po, unë.

9 Py. A ju kujtohet çfarë plagë kanë pasë?

10 Pë. Unë tash ndoshta - janë me të shkrume se është shkru
11 libri para 7-8 vjete e Sokoli ka qenë me disa plagë, mund të
12 them 7-8 plagë i ka pasë në trup prej copave të granatave, në
13 rruptura që ka aijna. Edhe unë jam mundu së pari - ai ka qenë
14 në gjendje shumë të rëndë anemike, me ia dhënë infuzionin, me
15 e ndihmu dhe pastaj me i qep plagët.

16 Py. Kjo ngjarje me Sokol Sopin, a ju kujtohet nga dita kur
17 keni shku për herë të parë në Zllash, pas sa ditëve ka qenë
18 kjo ngjarje?

19 Pë. Sa më kujtohet kjo ka qenë me Sokolin pas ofensivës.

20 Mbasi është bo ofensiva ka qenë me Sokolin.

21 Py. A mundeni përfaqësisht ditët me na i tregu?

22 Pë. Tani ofensiva ka qenë më datën 18. Aty kemi pasë të
23 plagosun të tjerë, në 18-shin. Muj me thonë në 18 s'kanë qenë
24 veç dy po kanë qenë ndoshta dhjetë të plagosun, të lënduar, dy
25 kanë qenë ma të rëndë, të tjerët më të lehtë, më 18. Ndërsa më

1 datën 19, më datën 19 i kanë prurë këta prej, s'di prej një
2 fshati që kanë qenë të plagosur, duhet me qenë 19-20, s'e mbaj
3 mend se u kanë ofensivë edhe jemi kanë të traumatizim. Nuk e
4 kemi mbajtur mend taman saktë kështu sikur...

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
6 Dëshmitare, për pyetjen e radhës, ju lutem prisni pesë sekonda
7 pasi ka përfunduar pyetjen Avokati para se të përgjigjeni ju
8 lutem.

9 Py. A ju kujtohet Sokol Sopi, pasi që i keni ofru ndihmën
10 mjekësore, a ka vazhdu të qëndron aty në Zllash, në q'atë
11 pjesë ku i keni ofru ndihmën apo e kanë mbart diku tjetër?

12 Pë. Sokol Sopi pastaj është mbart se ofensiva ka fillu. Ne e
13 kemi mbart me i shpëtu të plagosurit mos me ra në dorën e
14 serbëve se dihet aty masakrat si bahen. Dhe pastaj jemi du më
15 i mbajtur të plagosurit me i çu në zonat ma të lira. Dhe kur ka
16 shku në zonë ma të lirë, fatkeqësisht ai ka ra në pritë të
17 armikut, të forcave serbe. Ai me gjithë Isa Kastratin. Për fat
18 edhe unë kom qenë në atë makinë, po kam dalë me ec në kambë se
19 gjuheshin granatat direkt në makinën tonë. Dhe kam dalë
20 jashtë, fati im, sot me ardhë me tregu. Unë kam shpëtu. Sokol
21 Sopi me ushtarë të tjerë dhe Isën, 3 vetë i kanë vra forcat
22 armike i kanë masakru ata.

23 Pë. Faleminderit, znj. Dëshmitare.

24 Z. SHALA: [Përkthim] Nuk kam më pyetje. Faleminderit e
25 nderuar Gjykatëse.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk e
2 dëgjova, sepse po dëgjoja përkthimin. Nuk e kapa pjesën e
3 fundit të fjalisë.

4 Z. SHALA: [Përkthim] Asgjë. Nuk kam më pyetje të tjera.
5 Faleminderit.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Faleminderit.

8 Mirë pra. Po shoh nga ZPS-ja. Znj. Prokurore, a keni ju
9 pyetje shtesë për Dëshmitaren?

10 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Jo, e nderuara Gjykatëse, nuk
11 kemi pyetje shtesë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit, atëherë.

14 Atëherë nuk ka pyetje të tjera me sa shoh as nga
15 Mbrojtësja e Viktimave.

16 Mirë atëherë.

17 Znj. Hadri, ju kanë drejtuar pyetje Mbrojtja, ZPS-ja,
18 Mbrojtësja e Viktimave. Tani është radha e Trupit Gjykues t'ju
19 drejtoj disa pyetje. Kështu që keni pakëz më shumë durim. Dhe
20 shpresoj në këtë formë të qartësojmë disa nga gjërat që keni
21 thënë dje edhe sot, po edhe në deklaratat e mëparshme. Më
22 lejoni të shoh kolegët.

23 [Trupi Gjykues këshillohet]

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
25 Gjykatësi në të majtën time do t'ju drejtojë pyetje.

1 Fjala është për ju.

2 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit, znj.

3 Kryegjykatëse.

4 Pyetje nga Trupi Gjykses:

5 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Znj. Hadri, unë kam disa
6 pyetje për ju. Dje, në faqen 95, të transkriptit të djeshëm,
7 po diskutonit, po flisnit për dhomat e ndryshme dhe thatë
8 diçka që unë do ta lexoj. Unë do t'u lexoj atë që ju thatë:

9 "Ishte kjo dhoma për gratë, që ishte tek shtabi dhe ishte
10 dhe dhoma tjetër ku qëndronin burrat."

11 Kjo ishte përgjigjja juaj. Pastaj u bë një pyetje për ju:

12 "Pra kur thoni që vendi ishte shumë i vogël e keni fjalën
13 që dhomat ishin të vogla - më fal, dhomat që ju vizituat, e
14 para dhoma e burrave në shtab dhe e grave ishin shumë të
15 vogla. Këtë po thoni?"

16 Dhe ju u përgjigjët:

17 "Dhomat janë të vogla. Ishin afër njëra-tjetrës. Ishim të
18 gjithë në të njëjtin vend."

19 Këtu kemi tri opsione tani, tre alternativa. Ose gratë
20 ishin në shtab ose burrat ishin në shtab, apo ishit të gjithë
21 në të njëjtin vend. A mund të na e qartësoni pak këtë? A
22 flinte njëri në shtab dhe kush flinte atje?

23 Pë. Unë dje shumë mirë, nëse përkthimi s'di si ka qenë. Shumë
24 mirë e kam spjegu se nga shtabi kur më pyetët për dhomën e
25 fjetjes, i ka pasë nja dhjetë metra për me shku në dhomë të

1 fjetjes. Në shtab kanë qenë veç ato shilte. Ne shqiptarët
2 ulemi në vend të karrigave edhe aty ulesh, aty nuk ka fjetë...
3 Unë s'di cili ka fjetë se s'jam shku me i pa, me kqyr apo
4 flejnë. Kur është bo lufta, ti ke flejt edhe në dru, edhe në
5 shilte edhe në të gjithë... Unë, e thashë dje, kom ec dhjetë
6 metra - ndoshta mund të jetë se s'e kom mat metrin, ndoshta
7 mund të jetë edhe njëzet metra që kam shku me flejt në dhomën
8 teme, një dhomë shumë e vogël. Edhe dhomat kanë qenë si të
9 njëjta.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
11 ngadalë, ju lutem.

12 DËSHMITARJA: Dhomat kanë qenë në përgjithësi aty shumë të
13 vogla dhe nuk i kemi mat. Po nuk ka pasë mundësi me ndejt.
14 Burrat kanë ndejt ashtu veçantë, ne gratë kemi flejt e veçantë
15 në q'ato katër-pesë dyshekë që kanë qenë. Nuk kemi shku me pa
16 qysh po flejnë burrat.

17 Kështu e kom thonë nëse jam kuptu drejtë.

18 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në deklaratën që i keni dhënë
19 Mbrojtjes DSM00138, faqja 5, ju thatë:

20 "Askush nuk flinte në shtab."

21 Prandaj jam pak i paqartë sepse atje keni thënë nuk
22 flinte askush në shtab, ndërsa dje unë e kuptova - megjithëse
23 nuk ishte e qartë - e kuptova sikur flinte dikush në shtab,
24 qofshin këta burra apo gra.

25 A mund të na e sqaroni pak këtë? A flinte apo nuk flinte

1 njeri në shtab? Pra, nuk flinte siç i thatë Mbrojtjes apo
2 flinin?

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
4 Dëshmitare, më ngadalë ju lutem sepse duhet ta ndjekim, të
5 kenë mundësi përkthyesit ta ndjekin, ta kuptojnë atë që po
6 thoni.

7 Thoni ato që keni, doni, që doni të thoni - më falni -
8 po më ngadalë ju lutem.

9 DËSHMITARJA: Në shtab nuk ka flejt shtabi qysh e përshkru
10 në ato dhomat me shilte. Nuk ka flejt, nuk e kom pa, nuk ka
11 flejt kush. Unë s'jam shku me këqyr. Unë kam tregu, ndoshta e
12 keni ngatërru dhomën se aty me një qysh ka qenë një oborr -
13 unë kam flejt në dhomën time, në dhomën e grave. Kjo është.

14 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Në mënyrë të
15 përsëritur, i referoheni, përmendni shtabin në deklaratat e
16 ndryshme që keni dhënë sot, dje, po asnjëherë s'e keni
17 cilësuar. Shtabi i kujt, më falni? Kur thoni "shtabi" shtabi i
18 kujt, shtabi i kujt njësie, cilës brigadë, për çfarë?

19 Shtabi i kujt ishte ky?

20 Pë. Shtabi ka qenë shtabi i ushtarëve. Q'ashtu i thojnin.

21 Shtab i thojnin. Tjetër fjalë s'ka pasë. Q'ato dy dhoma i kanë
22 thonë shtab.

23 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Sepse thjesht i referoheshit
24 si shtabi jo shtabi konkretisht për diçka, thjesht shtabi.

25 Pë. Q'ashtu e ka pasë emrin, shtab.

1 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit.

2 Në faqen 13, rreshti 16 i transkriptit të djeshëm thatë
3 se ju çuan tek ky shtabi dhe Sejdi Veseli erdhi.

4 A erdhi ai tek ju apo ju çuan ju tek ai?

5 Sepse në deklaratat e ndryshme në faqen 4, thoni që: "më
6 çuan tek ai."

7 Pra a erdhi ai tek ju, apo ju çuan ju tek ai? A ju
8 kujtohet?

9 Pë. Ai ka ardhë aty. Ishte dhoma ku rrinte, me siguri rrinte
10 ai edhe ushtarët. Ai ka ardhë aty me pa mjeken që ka ardhë me
11 ndihmu në luftë edhe me u taku me mu, mirë se erdhe.

12 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Pra, ai erdhi tek dhoma ku
13 qëndronit ju? Nuk ju çuan ju tek ai, saktë?

14 Pë. Po, saktë. Ai erdhi.

15 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Çfarë diskutuat ju me të? A
16 ju kujtohet për çfarë folët me të? A ju kujtohet për çfarë
17 folët me të?

18 Pë. Po folëm për rrezikshmëninë si kam dalë edhe i kam kalu
19 postblloqet. Unë isha aty ma llafazanja se nga emocionet që
20 forcat serbe nuk më vranë në punkte e kisha marrë hovin me fol
21 dhe i tregova peripecitë që i kom kalu gjatë rrugës me forcat
22 serbe dhe me dëshirojë mirëseardhje dhe sukses "Vazhdoje punën
23 si e ndjeke këtu." Asgjë ma shumë. Dhe nuk kemi pasë mundësi,
24 asnjherë, as atëherë as tash me i kujtu ato ditë edhe me mu
25 kujtu ngjarjet sikur sot.

1 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] A e pyetët ju, ç'bënte ai
2 atje?

3 Pë. Jo, nuk e kom pyt se s'më ka interesu. Unë e kisha
4 profesionin tem.

5 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Ju e njihnit si teknik
6 laboratorit të një spitali në Prishtinë apo jo? E njihnit më
7 përpara?

8 Pë. Po, e njof, e njof edhe familjen. Edhe e kam grunë e tij
9 paciente. I kam të gjithë ata. E njof mirë edhe para lufte dhe
10 s'kishim çka flasim më shumë, veç "a shpëtove nga armiku?".

11 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Ju nuk u habitët kur e patë
12 atje si komandant ushtarak në Zllash?

13 Pë. Jo, unë nuk u habita.

14 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] A mund të na shpjegoni pse?
15 Ishte e natyrshme për personat që punonin në laborator të një
16 spitali të bëheshin komandant së ushtrisë së UÇK-së?

17 Pë. Jo, nuk ishte kjo një - nuk u habita se ai ka qenë
18 gjithmonë ai, familja e vet kanë luftu për të drejtat e
19 shqiptarëve ne Kosovë. Ka qenë një familje e ndershme dhe i
20 takonte me udhëheqë me qenë komandant i asaj zone. Dhe s'kisha
21 pse se është njëri shumë i ndershëm dhe ka qenë punëtor i mirë
22 në klinikë.

23 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Pra ishte e natyrshme, ishte
24 krejt normale për ju që të shihnit një laborant spitali të
25 bëhej komandant ushtrie, nuk u habitët pra?

1 Pë. Jo nuk u habita se aty u lypte forcë, aty lipej njeri i
2 gjallë, a mund t'i shërbejë kush. Dhe ai kishte dalë para meje
3 dhe kishte zënë pozitën. Kam mujt edhe unë me qenë komandante.

4 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Dhe një pyetje
5 tjetër. Pas ofensivës, me sa duket, me sa kuptuam u larguat
6 nga Zllashi më 19 prill. A u kthyet më në Zllash pas
7 ofensivës? Pra pas 19 prillit a u kthyet më në Zllash?

8 Pë. Pas 19 prillit.

9 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Po, pas 19 prillit.

10 Pë. Po, jemi kthyer për shkak se forcat serbe na ndiqnin në
11 çdo këmbë dhe nuk na lënë vend të zbresin me pacientë në Llap
12 kur na çun në Keçekoll apo Llap. Edhe ne prapë këta ushtarët,
13 i thonë trima para Trupit Gjykses, neve na shpëtuan, 8 të
14 plagosur i kishim me vete dhe një numri të madh të ushtarëve
15 na kanë kthy në zonë se Zllashi ishte djeg krejt shkumb. Dhe
16 ne s'kemi pasë as vend ku me flejt. Zllashi ka qenë i djegur
17 krejt ku jemi kthy dhe kemi flejt nëpër trungjet e drunjve, në
18 dru të kallur jemi ul, s'ka pasë as vende. Jemi kthy aty. Dy
19 orë kemi ndejt se përsëri forcat serbe me ato percjelljet e
20 veta kanë hetu se jemi kthy në Zllash. Përsëri na kanë filmu,
21 përsëri ne duhet të tërhiqemi prej Zllashit. Kanë qenë, muj me
22 thonë sa kujtoj, dy orë. Kurrë s'kemi pa, as shpi, as...

23 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Kur u kthyet në Zllash? A ju
24 kujtohet cila datë ka qenë?

25 Pë. Në Zllash sa më kujtohet, domethënë në 19 jemi mbart, do

1 19-20 ka qenë. Dhe mund ta gaboj datën, 19-20.

2 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Pra, serbët nuk qëndruan në
3 Zllash? Ata thjesht dëmtuan shtëpitë - më fal - granatuan
4 shtëpitë. Ishte shkatërruar Zllashi? Edhe kur u kthyet nuk
5 kishte më ku qëndronit në Zllash apo jo?

6 Pë. Ishte kall deri në themel çdo gjë. Edhe drunjtë ishin
7 kall. Disa dru çka kishin mbetë, aty jemi ul në drunj të
8 djegur. S'kanë pasë serbë më aty se e kishte arrit qëllimin, e
9 kishte kall Zllashin.

10 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] A u përpoqët të ktheheshit në
11 atë që ju e quani shtabi?

12 Pë. Po, s'kishte shtab.

13 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Po ju e patë që s'kishte më
14 gjë? E patë që ishte shkatërruar?

15 Pë. S'kishte gjë. Çdo gjë ka qenë e shkatërruar.

16 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Jo plotësisht në fakt sepse
17 nga fotografia që ju treguam është e 2006-s, kështu që
18 pjesërisht kishte ngelur diçka, kishin ngelur ca mure.

19 Ju vetë u kthyet? E patë ju vetë me sytë tuaj që shtabi,
20 e patë shtabin pas datës 20, pra pasi kishin ikur forcat
21 serbe? E patë ju vetë që s'ishte më?

22 Pë. Po, e pashë që s'ishte po unë nuk po i llogaris ato mure
23 të shkatërruara që kanë mbetë pa dritare. Ishte shkatërruar
24 çdo gja. Ne kemi hongër bukën aty se s'kemi hongër dy-tri ditë
25 që kemi qenë në male dhe në kambë e kemi hongër bukën dhe

1 s'kemi... e kam të shkrume edhe në ditar mbasi e keni të
2 përkthym. Edhe aty nuk u mujt as bukë të ha se na ka mbetë
3 buka në gojë. Na kanë sulmu forcat serbe. Në kambë kemi hongër
4 bukë se s'kemi pasë vende ku të ulemi.

5 Disa mure, themele kanë qenë. S'jam koncentru që e kom
6 dhonë këtë deklaratë se i kisha shkru të gjitha.

7 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Pastaj nga data
8 19-20 u larguat prapë nga Zllashi sepse po granatonin serbët
9 dhe u larguat njëherë e mirë. Nuk u kthyet më në Zllash apo
10 jo?

11 Pë. Jo, më nuk jemi kthy. Na kanë çu në Keçekollë me të
12 plagosur dhe Keçekolla ka qenë e djegur. Ajo ma e tmerrshmja
13 hin ke pluhni, tymi, ende kish flakë, ende kish zjarr.

14 Nga ne po q'ato ushtarët tonë shumë strategë nëpër forcat
15 serbe kemi hi ne aty. Ndoshta kanë mujt me qenë as dhjetë
16 metra forcat serbe në atë natë e në terr në Keçekollë. Nga
17 Keçekolla zumë në Zllash e Llapit dhe më nuk jam kthy kurrë.
18 Edhe kam pasë dëshirë me u kthy me pa atë zonë ku kanë luftu,
19 ku kanë luftu djemtë tanë.

20 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Pra hera e fundit që keni
21 parë Zllashin, ka qenë plus-minus data 20 prill apo jo, pak a
22 shumë?

23 Pë. Ashtu.

24 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit për të gjitha
25 përgjigjet tuaja.

1 Unë mbarova me pyetjet e mia.

2 Faleminderit, znj. Hadri.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

4 Hadri, arritëm në fund të dëshmisë suaj. Do të doja t'ju

5 falënderoja për dëshminë tuaj që besoj se do të na ndihmojë të

6 gjejmë, të zbulojmë të vërtetën.

7 Edhe njëherë faleminderit shumë.

8 Të uroj rrugë të mbarë dhe ju kujtoj të mos diskoni,

9 diskutoni - më falni - dëshminë tuaj, dëshminë që i keni dhënë

10 Dhomave të Specializuara me askënd.

11 Znj. Asistente e Gjykatës, ju lutem shoqërohemi znj.

12 Dëshmitare jashtë sallës.

13 DËSHMITARJA: Faleminderit edhe juve që patët durim me

14 ndëgju. Faleminderit.

15 [Dëshmitarja përfundon dëshminë]

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Faleminderit, znj. Asistente e Gjykatës.

18 Mirë pra, atëherë. Atëherë sugjeroj që të bëj pushimin

19 tani, pushim gjysëm ore, 30 minuta, çerek ore përpara

20 planifikimit dhe pastaj do vazhdojmë me dëshminë e Mbrojtjes

21 1700 që është znj. Ibadete Canolli-Kaciu.

22 Seanca ndërpritet për 30 minuta.

23 --- Pauza fillon në orën 10.44

24 --- Seanca rifillon në orën 11.15

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Mirë se jeni rikthyer. Të shohim cilët janë të pranishëm.

2 Shoh që jeni në të njëjtën përbërje por keni ndryshuar
3 vende.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës, e
5 njëjta përbërje por kemi ndryshuar vendet, meqenëse pyetjet
6 dëshmitarit tjetër do t'ja bëj unë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Faleminderit.

9 Mbrojtësja e Viktimave, shoh që si ju ashtu edhe znj.
10 Pues jeni të pranishëm, znj. Pues përmes Zoom-it dhe shoh që
11 edhe Mbrojtja ka të njëjtën përmbajtje si më përpara dhe z.
12 Mustafa është gjithashtu i pranishëm.

13 Shumë mirë do të vijojmë tani me dëshminë e dëshmitarit
14 të Mbrojtjes 1700, znj. Ibadete Canolli-Kaçiu.

15 Znj. Asistente e sallës, ju lutem shoqërojeni Dëshmitaren
16 të hyjë në sallë.

17 [Dëshmitarja hyn në sallën e gjyqit]

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
19 Canolli-Kaçiu mirëdita dhe mirë se keni ardhur në Dhomat e
20 Specializuara.

21 DËSHMITARJA: Përshëndetje, shkëlqesia juaj, e nderuara
22 znj. Gjykatëse, ju faleminderit për mikpritjen.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shoh
24 që më dëgjoni në rregull.

25 DËSHMITARJA: Po.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
2 pikë së pari, si jeni?

3 DËSHMITARJA: Mirë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
5 mirë. Znj. Canolli-Kaçiu, sot do të vijojmë me dëshminë tuaj.
6 Ju kanë thirrur të dëshmoni përpara Dhomave të Specializuara
7 në Çështjen Gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Salih
8 Mustafës, për ta ndihmuar Trupin Gjykes të marrë vendim. Pasi
9 të bëni deklaratën solemne për të thënë të vërtetën, do t'ju
10 bëj pyetje Avokati i Mbrojtjes, përfaqësuesi i Zyrës së
11 Prokurorit të Specializuar, dhe Mbrojtja e Viktima, dhe në
12 fund edhe anëtarët e Trupit Gjykes.

13 Dëshiroj, si me çdo dëshmitar, t'ju jap disa udhëzime se
14 si t'u përgjigjeni pyetjeve që do t'ju bëhen.

15 Znj. Canolli-Kaçiu, ju lutem dëgjojeni me kujdes secilën
16 pyetje. Nëse nuk e kuptoni, lirisht mund të kërkonit që pyetjen
17 tua përsërisin.

18 Duam të na tregoni të vërtetën, të na tregoni çfarë keni
19 dëgjuar, çfarë keni ndjerë, çfarë përjetuar, e çfarë keni parë
20 ju vetë. Nëse e keni marrë vesh në ndonjë mënyrë tjetër, na e
21 shpjegoni se si.

22 Mund të mos ju kujtohen të gjitha detajet e ngjarjeve.
23 Nuk ka problem për këtë. Mjafton të dëshmoni për aq sa mbani
24 mend. Nëse thoni "nuk e di, nuk e mbaj mend", nuk ka problem,
25 mund të na e thoni kështu.

1 Ju lutem përgjigjuni pyetjeve. Mos ju largoheni pyetjes,
2 se po të kemi nevojë për sqarime të tjera, do tua kërkojmë
3 edhe ato. Përpiquni që të qëndroni sa më e përqendruar te
4 pyetjet.

5 Ju rikujtoj se në se pyetjet, ose më saktë përgjigjet
6 ndaj pyetjeve mund t'ju fajësojnë, keni të drejtën mos t'u
7 përgjigjeni.

8 I kuptuat të gjitha këto?

9 DËSHMITARJA: Po.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
11 mirë. Dëshiroj t'ju jap edhe disa këshilla praktika se si ta
12 jepni dëshminë tuaj.

13 Çdo gjë që e themi këtu në këtë sallë, përkthehet dhe
14 regjistrohet, prandaj është shumë e rëndësishme që të flisni
15 sa më afër dy mikrofonave që i keni përpara, mbase është
16 nevoja t'i afroni diçka më shumë për të folur pranë
17 mikrofonit, siç vepruat tani, të flisni qartë dhe të flisni
18 ngadalë, sepse kjo u jep mundësi përkthyesve që të përkthejnë
19 gjithçka. Ngul këmbë që të flisni ngadalë, është shumë e
20 rëndësishme, sepse nëse do të filloni të flisni shumë shpejtë,
21 pastaj ndërlikohet shumë puna për të përkthyer, por edhe për
22 ne që të përcjellim dëshminë tuaj e ta kuptojmë.

23 Duhet të filloni të flisni vetëm pasi të ketë mbaruar së
24 foluri personi që jua bën pyetjen, edhe atëherë të prisni pesë
25 sekonda. Mund t'ju duket e panatyrshme kjo gjë, por përpiquni

1 që të mbani parasysh edhe këto pesë sekonda pauzë mbase nga
2 fillimi i dëshmisë suaj mund t'ju ndërpre disa herë, se është
3 vënë re këtu në sallë që nuk është e lehtë, të paktën në
4 fillim të respektohet ky pesë sekondësh, por për ne është
5 shumë e rëndësishme, në mënyrë që të përcjellim përkthimin e
6 pyetjes që do të bëjë Avokati i Mbrojtjes, por pastaj edhe të
7 përgjigjes suaj. Se nëse do të ketë vendosje, është e pa
8 mundur, se përkthyesi mund të përkthejë vetëm njërin folës.

9 Nëse unë do të ngre dorën kështu, ju lutem mos flisni më.
10 E ngre dorën sepse po të filloj të flas edhe unë, atëherë kemi
11 edhe një folës tjetër që mbivendoset mbi atë që flet.

12 A flisni anglisht?

13 DËSHMITARJA: Kuptoj.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
15 rregull. Në këtë rast, nëse ndonjëra prej palëve, apo
16 Mbrojtësja e Viktimave do të dëshirojë të diskutojë diçka
17 lidhur me përmbajtjen e pyetjes që ua bëjnë, do t'i kërkoja
18 asistentes së sallës t'ju shoqërojë juve të dilni nga salla,
19 në mënyrë që të diskutojmë lirisht për përmbajtjen e pyetjes
20 dhe pastaj do t'ju kërkojmë që të ktheheni prapë në sallë,
21 sepse nuk duam që t'ju ndikojmë në përgjigjen tuaj lidhur me
22 ato çka do të diskutojmë.

23 Po të keni pyetje, po të keni nevojë për pushim, mjafton
24 të ngrini dorën, dhe unë do tua jap fjalën, dhe pastaj mund të
25 na e shpjegoni se për çfarë keni nevojë.

1 I kuptuat të gjitha këto?

2 DËSHMITARJA: Po.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
4 mirë. Si me çdo dëshmitar, do t'ju kërkoj tani që të lexoni
5 deklaratën solemne për të thënë të vërtetën. Ju rikujtoj se
6 përbën vepër penale në juridiksionin e Dhomave të
7 Specializuara dhënia e dëshmisë së rrejshme. E kuptoni këtë?

8 DËSHMITARJA: Po.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
10 mirë.

11 Znj. Asistente e sallës, ju lutem ndihmoheni Dëshmitaren
12 me deklaratën solemne për të thënë të vërtetën.

13 Znj. Canolli-Kaçiu, ju lutem lexoni tekstin që sapo ju
14 kanë dhënë.

15 DËSHMITARJA: E ndërjegjeshme për rëndësinë e dëshmisë
16 sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do
17 të them të vërtetën, krejt të vërtetën, dhe vetëm të vërtetën,
18 dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

19 DËSHMITARJA: IBADETE CANOLLI-KAÇIU

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit, Znj. Canolli-Kaçiu. Tani jeni nën betim për të
22 thënë të vërtetën.

23 Mund të fillojmë tani me dëshminë e Dëshmitares duke
24 filluar me pyetjet që do të t'i bëjë Avokati i Mbrojtjes.

1 Ju rikujtoj se kemi lejuar Mbrojtjen që t'i bëjë pyetjet
2 në gjuhën shqipe, me emalin e datës 19 prill të vitit 2022, të
3 orës 12.23 minuta. U tha për procesverbalin.

4 Z. Avokat, ju keni vlerësuar se ju nevojiten dy orë. Si
5 zakonisht mjafton ta informonit Trupin Gjykses nëse ka
6 ndryshime sa i takon planifikimit. Keni fjalën.

7 Z. SHALA: [Përkthim] Faleminderit, e nderuara Gjykatëse,
8 patjetër që do ju informoj.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
10 hir ta planifikimit, z. Avokat, tani do të bëjmë një seancë,
11 një orë e 30 minuta, deri në orën një pa një çerek.

12 Z. SHALA: [Përkthim] Po në rregull.

13 Pyetje nga Z. Shala:

14 Py. [Në shqip] Mirëdita, z. Dëshmitare.

15 Pë. Mirëdita.

16 Py. Sot do të dëshiroja të bisedoj me ju për ngjarjet në
17 Kosovë nga muaji mars dhe prill i vitit 1999.

18 Gjatë kësaj periudhe kohore, ku keni jetuar?

19 Pë. Në fillim të marsit të vitit 1999 unë kam jetuar në
20 Prishtinë, kam punuar në qendrën rehabilituese, te Flora
21 Brovina, doktoreshë pediatrike, deri më 24 mars, kur kanë
22 filluar bombardimet e NATO-s. Nga 24 marsi deri me 31 mars kam
23 qëndruar në shtëpinë time. Me 31 mars ka filluar shpërngulja e
24 popullsisë, të banorëve të Prishtinës. Forcat paramilitare dhe
25 militare serbe kanë dashur të bënin spastrim etnik dhe na kanë

1 dëbuar nga shtëpitë tona. Prej asaj date, deri më datën 16
2 prill, kam qëndruar në një shtëpi në fshatin Mramor me
3 familjen e time të gjerë, në shtëpinë e pronarit Afrim Gashi.
4 Ndërsa nga data 16 mars, ju kam bashkëngjitur gueriles së
5 Prishtinës në Zllash.

6 Py. Faleminderit, znj. Dëshmitare. Vetëm që ta kem unë më të
7 qartë, thatë nga 16 marsi ju i jeni bashkuar gueriles?

8 Pë. 16 ..

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
10 Dëshmitare, ju lutem numëroni me vete deri në pesë: një, dy,
11 tre, katër, pesë. Mbase mund ta bëjnë edhe kështu, kur të jem
12 duke dëgjuar përkthimin e pyetjes së avokatit, do vështroj nga
13 Avokati dhe vetëm kur të kthej vështrimin drejt jush dhe tua
14 bëj me kokë, atëherë mund të filloni të flisni. Është e
15 vështirë në fillim, po sa të mësohemi.

16 Z. SHALA:

17 Py. Edhe një herë nga cila datë keni shkuar në Zllash?

18 Pë. Data 16 prill.

19 Py. Pse jeni aq e sigurt që ka qenë data 16 prill?

20 Pë. Sepse kanë qenë dy ditë para ofensivës.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
22 Dëshmitare, ju lutem prisni, vështroni nga unë deri sa unë tua
23 bëj shenjë me kokë. Sepse kur të filloni të flisni ju, unë jam
24 ende duke dëgjuar pyetjen e Avokatit në përkthim dhe nuk ju
25 dëgjoj dot juve se ç'thoni. E kuptoni mekanizmin?

1 Është shumë e rëndësishme. Mos flisni menjëherë. Kohë
2 kemi. Edhe sot, edhe nesër. Nuk e kemi me ngut. E kuptoj që
3 është disi ndryshe nga rastet e tjera, e kuptoj që nuk është e
4 lehtë por përpara se të flisni, vështroni nga unë, dhe të
5 flisni pasi tua bëj me shenjë me kokë.

6 Mund të vazhdoni, z. Avokat. Ju lutem të përsërisni
7 pyetjen.

8 Z. SHALA:

9 Py. Pse jeni aq e sigurt që ka qenë data 16 prill dita kur
10 keni shkuar për në Zllash?

11 Pë. Sepse kanë qenë dy ditë para ofensivës, para luftimeve të
12 zonës operative të -- në Zllash, ku kemi qenë.

13 Py. Pse e vendosët që të shkoni në Zllash?

14 Pë. Unë edhe më herët kam kontribuar për ushtrinë dhe kam
15 qenë pjesë e njësisë, mirëpo veprimi im ka qenë në Prishtinë
16 dhe atëherë forcat paramilitare dhe militare ju afruan
17 vendbanimit ku unë isha. Për shkaqe sigurie të anëtarëve të të
18 gjithë atyre banorëve, unë vendosa me ju bashku ushtrisë.

19 Py. Dhe thatë ishit pjesëtare e ushtrisë dhe e njësisë. A
20 mund të na tregoni të cilës njësi?

21 Pë. Që nga marsi i vitit 1998 unë kam kontribuar për Ushtrinë
22 Çlirimtare të Kosovës. Fillimisht në regjionin e Prishtinës
23 dhe në zonat e prekura të luftës, kryesisht në zonën e
24 Drenicës. Kam punuar me doktoreshën Flora Brovina, me
25 popullsinë civile, dhe të plagosur. Ndërsa kontaktet me

1 ushtarët e gueriles i kam pasur po në atë qendër.

2 Py. Guerile a kishte ndonjë emërtim?

3 Pë. Guerile quhej BIA. Inicialet e tre heronjve të kombit,
4 Bahri, Ilir dhe Agron.

5 Py. Deri në Zllash në çfarë mënyrë keni shkuar, si udhëtuat
6 deri atje?

7 Pë. Në këmbë.

8 Py. A udhëtuat vetëm, apo ishit me dikë tjetër?

9 Pë. Fillimisht, dy ditë më herët, i pata thënë pronarit të
10 shtëpisë të më kontaktojë me ushtarët, dhe atë ditë kanë
11 ardhur më kanë marrë tre ushtarë.

12 Py. A ju kujtohet sa ka zgjatur rruga deri në Zllash?

13 Pë. Ndoshta më tepër se tre orë.

14 Py. Këta tre ushtarët që kanë qenë me ty bashkë, që keni
15 shkuar për Zllash, a kanë qenë edhe ata pjesëtarë të gueriles
16 BIA?

17 Pë. Nuk e di, nuk më kujtohen.

18 Py. Kur shkuat në Zllash, a ju kujtohet ku, në cilën pjesë të
19 Zllashit keni shkuar?

20 Pë. Ju kërkoj falje për territoret regjionale, unë kam qenë
21 fëmijë e lindur në Prishtinë, e rritur në Prishtinë, nuk e kam
22 njohur territorin, por ka qenë ndoshta shtëpitë e fundit të
23 fshatit.

24 Py. Kur keni arritur tek ato shtëpi, a mund të na përshkruani
25 pamjet përafërsisht, si dukej ai vend? Sa shtëpi kishte, a

1 ishte një shtëpi, apo më shumë?

2 Pë. Nuk mund të përshkruaj detajisht, ka kaluar kohë e gjatë,
3 por kanë qenë disa shtëpi të shpërndara.

4 Py. Kur arritët në Zllash, tek ato shtëpi, a duhej t'i
5 lajmëroheni dikujt?

6 Py. Jo. Unë kam hyrë lirshëm.

7 Py. A ka pasur nevojë të njoftohej dikush aty që ju, si
8 pjesëtare e ushtrisë dhe pjesëtare e njësitit keni ardhur në
9 atë vend?

10 Pë. Disa prej tyre më kanë njohur. Unë s'e kam njoftuar --
11 pronari i shtëpisë që unë jam në shtëpinë e tij, po unë s'kam
12 pasur nevojë me ju lajmëru askujt.

13 Py. A ju kujtohet kë keni takuar aty prej atyre personave që
14 i keni njohur?

15 Pë. Në fund të oborrit më kujtohet ka qenë një bunar. Aty
16 afër kam takuar Isa Kastratin.

17 Py. Kush ka qenë Isa Kastrati?

18 Pë. Isa Kastrati ka qenë një udhëheqës i gueriles të cilin e
19 kam takuar edhe në Prishtinë.

20 Py. A keni ndenjtur në atë pjesë tek ato shtëpi pastaj?

21 Pë. Po, për dy ditë.

22 Py. A ju kujtohet ku jeni vendosur?

23 Pë. Në objektin e sipërm, që ka qenë afër atij bunarit, ku
24 unë e përshkrova. Ka qenë një objekt pak më i ri, sigurisht i
25 ndërtua më rishtas. Aty ka qenë një dhomë me një nën-ndarje të

1 vogël. Dhomën e vogël e kam pasur një barnatore të vogël, dhe
2 një shtrat ku unë aty kam qëndruar.

3 Z. SHALA: Të nderuar Gjykatës, me lejen tuaj i kërkoj
4 Sekretares së Gjykatës që të vendosë në ekran një dokument.
5 Është një fotografi shtëpie.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
7 sekretare, mund të vijoni.

8 Z. SHALA: Faleminderit. Me numër DSM00159.

9 Py. Znj. Dëshmitare, në ekran para jush a është një
10 fotografi? A është paraqitur një fotografi?

11 Pë. Po.

12 Py. Në këtë fotografi, në pjesën e majtë, a është emri juaj
13 dhe nënshkrimi juaj?

14 Pë. Po.

15 Py. A e njihi këtë hapësirë, këto objekte këtu, që paraqiten
16 në këtë fotografi?

17 Pë. Nuk mundem të definoj.

18 Py. Kur thoni "nuk mundem të definoj", çfarë do të thotë kjo.
19 Nuk e njihi apo nuk mund të kujtoheni?

20 Pë. Për dy ditë unë sa kam qëndru, më shumë kam qëndru
21 brenda, kam bërë përgatitje për ofensivën që po na pret,
22 domethënë nuk kam pasur shumë qarkullim neperë oborr. Nuk po
23 më kujtohen.

24 Py. Faleminderit.

25 Z. SHALA: A mund të vendosim edhe një fotografi tjetër në

1 ekran.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Patjetër. Znj. Sekretare, mund të vijoni.

4 Z. SHALA: Mund ta hiqni nga ekрани këtë fotografi ju
5 lutem dhe të vendosni dokumentin DSM00156.

6 Py. Znj. Dëshmitare, a e keni një fotografi në ekran para
7 kompjuterit tuaj? Ekranit të kompjuterit.

8 Pë. Po.

9 Py. Nga kjo fotografi, a mund të identifikoni ku gjendet kjo
10 pjesë?

11 Pë. Nuk e kujtoj.

12 Py. Gjatë kohës kur keni qenë në Zllash, këto objekte a i
13 keni parë?

14 Pë. Jua thasë edhe më herët, nuk kam pasur shumë qarkullim
15 nëpër oborr, nuk më kujtohet se i kam parë. Nuk më janë
16 ngulitur.

17 Py. Faleminderit.

18 Z. SHALA: [Përkthim] A mund të kërkoj të vendosim një
19 fotot tjetër ju lutem?

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
21 mund të vijoni.

22 Z. SHALA: DSM00160.

23 Py. Znj. Dëshmitare, në këtë fotografi shihet një vijë e
24 kuqe. A ju kujtohet, a e keni bërë ju vetë këtë vijë në këtë
25 fotografi, në kohën kur Avokatit Mbrojtës i keni dhënë

1 deklaratë?

2 Pë. Po.

3 Py. Çka tregon objekti i potencum me këtë vijë?

4 Pë. Mendoj se këtu ka qenë bunari dhe afër tij pema për të
5 cilën fola më parë.

6 Py. Pra, kjo pemë është vendi ku e keni takuar Isa Kastratin
7 ditë kur keni shuar në Zllash?

8 Pë. Po.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
10 ta kuptuar unë, më kujtohet që kemi diskutuar për një pus dhe
11 për pemë kemi folur. Po ju pyes juve.

12 Z. SHALA: Vetëm për pemën.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
14 po ta them ndryshe, ta formuloj ndryshe.

15 Në deklaratën e Dëshmitares, është diskutuar për ndonjë
16 pemë deri më sot? Se mua është kujtohet vetëm një pus.

17 Z. SHALA: [Përkthim] Do ta gjej.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
19 po flas për deklaratën e mëparshme të kësaj Dëshmitareje, por
20 për sot.

21 Nëse nuk e gjemë dot menjëherë mundtë veprojmë kështu:

22 Znj. Dëshmitare, po ceknit tani një pemë. Mund të thoni
23 diçka më shumë se ku ndodhej kjo pemë?

24 DËSHMITARJA: Pema ka qenë brena rrethojës, afër bunarit.

25 Aty ka qenë i mbështetur Isa Kastrati, duke dëgjuar lajmet.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
2 të vazhdoni, z. Avokat.

3 Z. SHALA:

4 Py. Znj. Dëshmitare, aq sa ju kujtohet, a mund të përshkruani
5 objektin që ju kujtohet në atë kohë në afërsi të bunarit, që
6 shihet edhe në këtë fotografi, në anën e djathtë të bunarit?
7 Pë. Mendoj që ky ka qenë objekti i rinovuar, ku unë kam
8 qëndruar në njërën pjesë, ndërsa në pjesën tjetër ka qenë me
9 ndarje. Kanë qenë ushtarët dhe dy familje me fëmijë. Familja e
10 Fatmir Humollit dhe e plakut, axha Medi.

11 Py. A ju kujtohet sa kohë qëndruat në Zllash?

12 Pë. Në mbrëmjen e 16 (prillit) kam filluar menjëherë me
13 pastrimin e ambientit. Kanë qenë disa batanije që kemi bërë
14 disa lese të mundshme. Kam klasifikuar materialin, domethënë
15 kam bujtur atë natë. Me datë 17 tërë ditën kam përgatitur
16 material shpenzues. Me datën 18 kanë filluar bombardimet në
17 mëngjes. Me 19 -- në datën 20 kemi kaluar natën në një mal,
18 mbi shtëpi, domethënë në ambient të hapur, deri më datën 21,
19 kur i kemi tërhequr të plagosurit dhe jemi nisur për Majac.
20 Domethënë prej datës 16 deri më datën 21.

21 Z. SHALA: Faleminderit, znj. Dëshmitare.

22 Znj. Sekretare, mund ta hiqni këtë fotografi.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
24 Avokat, dëshiroj që t'i kthehem faqes në të cilën jeni tani,
25 faqja 24, rreshti 4, sepse nuk e kuptoj mirë përgjigjen e

1 Dëshmitares. Preferoj që të sqarojmë përpara se të vijojmë.

2 Znj. Dëshmitare, ju kërkua që të përshkruani ndërtesën që
3 ju kujtohet se ndodhej pranë pusit. Dhe këtu thatë se:

4 "...kjo ishte ndërtesa më e re, ku unë qëndrova,
5 hyra...".

6 Çfarë doni të thoni me këtë, po qëndronit aty? çfarë po
7 bënit aty? Apo ndodheshit aty kur biseduat me z. Kastrati?

8 DËSHMITARJA: Aty kam qëndruar pastaj, ato ditë të cilat
9 kam qëndruar, kam qëndruar në këtë objekt.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Qëndruat në atë ndërtesë që kemi parë në fotografi, pastaj
12 thoni:

13 "... brenda një pjese të saj, ndërsa në pjesën tjetër
14 kishte ushtarë dhe dy familje me fëmijë".

15 Mos vallë keni dashur të thoni që kjo shtëpi ku ju
16 qëndruat ishit së bashku edhe me ushtarë që qëndronin aty, si
17 edhe me dy familje të tjera?

18 DËSHMITARJA: Po. Kanë qenë femra ushtare.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
20 rregull. Të shohim nëse e kemi sqaruar të gjitha. Po, dhe
21 ishte edhe familja e Fatmir Humollit dhe e dikujt tjetër. Në
22 rregull, faleminderit, znj. Dëshmitare.

23 Z. PELAJ: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, përmendi edhe
24 emrin e personit tjetër, por nuk u fut në transkriptim.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,

1 do ta bëj pyetjen.

2 Z. PELAJ: [Përkthim] Ju lutem.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
4 rregull. Ju kujtohet emri i familjeve që qëndronin aty? Shikoj
5 që në transkriptim, procesverbal ceket emri i -- pra familja e
6 Fatmir Humollit. Ju kujtohet edhe emri i familjes tjetër?

7 DËSHMITARJA: Po. E kemi quajtur "Plak. Axha Medi".

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Faleminderit.

10 Z. Avokat, mund të vijoni.

11 Z. SHALA: Faleminderit.

12 Py. Znj. Dëshmitare, thatë në këtë objekt, shtëpi më e re.
13 Për aq sa e mbani ju mend, a ka pasur edhe objekte të tjera
14 përreth kësaj shtëpie?

15 Pë. Afër saj ka qenë kuzhina dhe mbi të, ma merr mendja që
16 kanë qenë dhomat që kanë qëndruar ushtarët. Por unë në pjesën
17 e sipërme nuk kam hyrë, në kuzhinë kam hyrë veç një herë.

18 Py. Në këtë hapësirë a ka pasur edhe ndërtesa të tjera për
19 përdorime të ndryshme?

20 Pë. Nuk e di.

21 Py. Gjatë kohës sa keni qëndruar në Zllash, a e keni takuar
22 Salih Mustafën?

23 Pë. Salih Mustafën e kam takuar me datën 21, kur kemi filluar
24 me i zhvendosur të plagosurit për në Majac.

25 Py. Më herët a e keni takuar?

1 Pë. Para shkuarjes në Zllash, në Prishtinë po, ndërsa gjatë
2 ditëve sa kam qëndruar në Zllash, jo.

3 Py. Kur e keni takuar në Prishtinë më herët, a ju kujtohet
4 cila ka qenë arsyeja që jeni takuar me Salih Mustafën?

5 Pë. Salih Mustafa, me sa kujtoj, ka qenë përgjegjës për
6 sigurimin e civilëve dhe ushtarëve në zonën ku ky ka vepruar,
7 dhe këtë përgjegjësi e ka ndarë bashkë me doktoreshën Flora
8 Brovina. I kam takuar në ordinancën ku kam punuar aty.

9 Py. Gjatë këtyre ditëve, a i keni ofruar ndihmë mjekësore
10 ndonjë pjesëtari të ushtrisë apo qytetari i cili ka qenë në
11 Zllash?

12 Pë. Po.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Prisni.

15 Z. Prokuror, keni fjalën. Kemi nevojë që ta shoqërojmë
16 Dëshmitaren që të dalë nga salla?

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo medoemos. Dhe pyetja mund të
18 jetë paksa pështjelluese, sepse fjala filloi me fjalët "gjatë
19 këtyre ditëve" ndërsa në rreshtat e mëparshëm po diskutohej
20 për çështjen e takimit të Dëshmitares me Salih Mustafën në
21 Prishtinë. Tani për cilat ditë, për ditët në Prishtinë apo për
22 ditët Zllash? Mbase mund të ishit disi më të qartë. Për të mos
23 e ngatërruar edhe Dëshmitaren.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
25 kuptoj.

1 Z. Avokat, ju lutem vazhdoni duke mbajtur parasysh edhe
2 sugjerimin e z. Prokuror.

3 Z. SHALA:

4 Py. Znj. Dëshmitare, gjatë kohës 16 prillit dhe deri më 21
5 prill, kur keni qenë në Zllash, a i keni ofruar ndihmë
6 mjekësore ndonjë pjesëtari të Ushtrisë Çlirimtare apo edhe
7 ndonjë qytetari aty në Zllash?

8 Pë. Po.

9 Py. Kjo ndihma mjekësore ndaj ushtarëve, a ka qenë ndaj
10 ushtarëve që kanë qenë -- s'janë ndjerë mirë me shëndet apo
11 kanë qenë të lënduar?

12 Pë. Edhe gjatë plagosjes së tyre, po edhe ata të cilët nuk
13 janë ndjerë mirë. Kanë qenë disa me probleme shëndetësore,
14 ftohje, diarre. Me aq sa kam pasur mundësi, i kam ofruar
15 ndihmë.

16 Py. Gjatë kohës sa keni qëndruar në Zllash, prej 16 prillit
17 deri më 21 prill, a jeni larguar ndonjëherë nga ajo pjesë ku
18 keni qenë e vendosur? Nga ajo shtëpi që e pamë në fotografi?

19 Pë. Ndoshta vetëm një herë, tërheqjen e një të plagosuri. Ka
20 qenë Osmani, 300-400 ka qenë larg objekti, në pjesën e
21 poshtme. Kam shuar e kam tërhequr me tre ushtarë. Përndryshe,
22 asnjëherë asnjë herë s'jam larguar.

23 Py. A ju kujtohet gjatë kohës kur keni shkuar në atë lokacion
24 në Zllash, dhe gjatë ditëve që keni ndenjur aty, a ka qenë një
25 lokacioni i rrethuar?

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Prisni pak. Rrethuar nga kush?

3 Z. SHALA:

4 Py. Me rrethore.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

6 rregull atëherë, OK.

7 Mirë faleminderit. vazhdoni. Vazhdoni, znj. Dëshmitare.

8 DËSHMITARJA: Jo. Kanë qenë disa taraba, gjysmë të
9 rrënume, që ne i quajmë në zhargonin popullor, por nuk ka qenë
10 rrethuar.

11 Z. SHALA:

12 Py. Gjatë kohës sa ju keni qëndruar në Zllash, këto objekte,
13 a kanë qenë të ruajtur nga rojet? A ka pasur roje?

14 Pë. Jo, nuk kam vërejtur diçka të tillë.

15 Py. Gjatë kohës a ju keni qenë në Zllash, a keni parë që ka
16 pasur persona të ndaluar? Përkatësisht që kanë qenë të izoluar
17 në një hapësirë të caktuar?

18 Pë. Jo.

19 Py. Gjatë kohës sa ju keni qenë në Zllash, a keni parë apo
20 keni dëgjuar që dikush të jetë maltrajtuar aty në atë
21 lokalitet?

22 Pë. Jo.

23 Py. Gjatë kohës kur ju keni qenë në Zllash në atë lokalitet,
24 a ka pasur ushtarë të tjerë përveç atyre që i keni njohur?

25 Pë. Kapasur ushtarë me uniformë dhe ushtarë pa uniformë.

1 Domethënë, jo të gjithë kemi qenë të uniformuar. Unë disa i
2 kam njohur se kanë qenë banorë të lagjes tim ku unë kam
3 jetuar. Kam njohur disa ushtarë, por ju kërkoj falje, nuk kam
4 mundur me i njoh të gjithë ushtarët. Detyra ime ka qenë
5 përgjegjësia për shëndetësi. Nuk kam mujt me njoh krejt
6 ushtarët. Ka pasur edhe njerëz që s'i njoh.

7 Py. Gjatë kohës sa ju keni qenë në Zllash, në atë lokalitet,
8 a ka pasur edhe civilë?

9 Pë. Po.

10 Py. Gjatë kohës sa ju keni qenë në Zllash në atë lokalitet, a
11 keni qenë të lirë për të dalë nga ai lokalitet?

12 Pë. Nuk më ka penguar kurrkush, por s'mu kanë dhënë
13 mundësitë.

14 Py. Gjatë kohës sa ju keni qenë në Zllash në atë lokalitet,
15 dhe në nëse do të kishit mundësi të largoheni nga ai
16 lokalitet, a është dashur të merret leje nga dikush për t'u
17 larguar?

18 Pë. Nuk e di, jo.

19 Py. Gjatë asaj kohe sa ju keni qenë në Zllash në atë
20 lokalitet, a ju kujtohet a ka pasur energji elektrike? Rrymë?

21 Pë. Jo. Me patate, i kemi mbushur me vaj, drita të vogla dhe
22 akumulatorët -- të tjera.

23 Py. Ju personalisht a ju kujtohet, a keni parë televizor në
24 atë lokalitet?

25 Pë. Jo.

1 Py. Ditën kur jeni takuar me Isa Kastratin, me ditën kur keni
2 mbërritur në Zllash, më 16 prill të vitit 1999, pas asaj dite,
3 a e keni takuar më Isa Kastratin?

4 Pë. E kam takuar çdo ditë, deri më datën 21 prill, kur edhe
5 ai është vrarë.

6 Py. A e dini ngjarjen si është vrarë?

7 Pë. Kemi qenë duke i tërhequr të plagosurit. Ai ka qenë me
8 një veturë me Sokol Sopin dhe Afrim Vitin me një udhëkryq.
9 Kemi pasur planin për me vazhdu për Majac. Ai ka vazhdu me një
10 drejtim tjetër. I kemi ndjerë krismat. Domethënë është vrarë
11 duke luftuar me armikun.

12 Py. Gjatë kohës sa ju keni qenë në Zllash më datë 16 prill
13 deri më 21 prill, a ju kujtohet a keni takuar një doktoreshë
14 aty?

15 Pë. Nuk jam e sigurt, mes datës 19 apo 20, ushtarët të cilët
16 kanë qenë në vijë të frontit kanë ardhur e më kanë thënë që
17 një i plagosur është diku 400 metra afër lokacionit, është
18 duke e qepur dikush. Ajo kohë ka qenë -- shumë granatime. Ka
19 qenë edhe luftë frontale, dhe i kam thënë ushtarëve, a mundeni
20 të më afroni me e pa se kush është. Kam shkuar, kemi marrë një
21 lesë me vete, i jam afruar afër, e kam përshëndetur dhe e kam
22 pyetur "kush jeni ju"? Tha: "Unë jam doktoresha Hadri, Teuta
23 Hadri, me profesion gjinekologe". I thashë "doktoreshë, të
24 kërktoj falje, në këtë ambient nuk mundesh me vazhdu me qep të
25 plagosurit. Është një rregull mjekësor që të lënduarin së pari

1 duhet ta sigurosh ambient të sigurt për veten e për atë, e
2 pastaj të fillosh me procedura. Një ndihmë e parë është në
3 rregull me dhënë, por jo me vazhdu më tutje". Nuk e kam
4 zgjatur më shumë, e kemi ngarkuar në ato lesat që i kemi bërë
5 prej batanije dhe e kam transportuar në pjesën e sipërme. Ja
6 kam bërë -- ka qenë Osmani -- ja kam bërë një tamponatë, ja
7 kam dhënë një infusion. Ndërsa në mbrëmje doktoresha ka ardhur
8 dhe e ka vazhduar qepjen.

9 Py. Gjatë kohës sa ju keni qenë në Zllash, 16 prill - 21
10 prill të vitit 1999, a keni dëgjuar ndonjëherë që dikur është
11 duke u thirrur me emrin Tabuti?

12 Pë. Jo.

13 Py. Gjatë kohës sa ju keni qenë në Zllash, 16 prill - 21
14 prill të vitit 1999 a keni dëgjuar ndonjëherë që dikë janë
15 duke e thirrur me emrin Dardani?

16 Pë. Jo.

17 Py. Gjatë kësaj kohe që ju keni qenë në Zllash, 16 prill - 21
18 prill të vitit 1999, a keni dëgjuar që dikush është duke u
19 thirrur me emrin Ilmi Vela?

20 Pë. Jo.

21 Py. Gjatë kohe, 16 prill - 21 prill të vitit 1999 aty në
22 Zllash a keni dëgjuar që dikush është duke u thirrur me emrin
23 Vdekja?

24 Pë. Jo.

25 Z. SHALA: [Përkthim] Më falni të konsultohem pak me

1 kolegët e mi.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Vazhdoni, Avokat.

4 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

5 Z. SHALA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kam më
6 pyetje të tjera për këtë dëshmitar.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Faleminderit, Avokat.

9 Z. SHALA:

10 Py. Znj. Dëshmitare, Mbrojtja nuk ka më pyetje për ju.

11 Pë. Faleminderit.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
13 atëherë.

14 Z. Prokuror, do të preferonit të bëjmë pushimin tani dhe
15 pastaj të bëni kundra pyetjet apo doni të filloni që tani me
16 kundra pyetjet.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të
18 parapëlqëja pushim, sepse dua që të përgatis edhe referenca
19 për kundra pyetjet.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
21 mirë atëherë.

22 Mirë atëherë. Ora është 12:05. Do të bëjmë pushimin një
23 orë e gjysmë për drekë, deri në orën 13:30, dhe do të
24 mblidhemi në orën 13:30 me dëshminë e Dëshmitares, për të
25 vazhduar me dëshminë.

1 Znj. Asistente, ju lutem shoqërojeni Dëshmitaren jashtë
2 sallës së gjyqit.

3 Znj. Dëshmitare, do ju sjellim në sallën e gjyqit në orën
4 13:30 ku do të vazhdojmë edhe me kundra pyetjet nga Zyra e
5 Prokurorit të Specializuar.

6 DËSHMITARJA: Faleminderit.

7 [Dëshmitarja përfundon dëshminë]

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Faleminderit. Atëherë bëjmë pushimin dhe mblidhemi në orën
10 13.30.

11 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.07

12 --- Seanca rifillon në orën 13.30

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
14 se u kthyet.

15 Atëherë, vërej që jemi në të njëjtën përbërje sikurse
16 edhe para pushimit. Shumë mirë.

17 Znj. Sekretare e Gjykatës, ju lutem a mund të sillni
18 dëshmitaren.

19 Në momentin që do vij dëshmitarja, do të jap dhe një
20 urdhër me gojë.

21 [Dëshmitarja vijon dëshminë]

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA[Përkthim] Mirë se
23 u kthyet, znj. Dëshmitare.

24 DËSHMITARJA: Mirë se ju gjeta sërish.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Par

1 se të fillojmë me kundrapyetjet nga Zyra e Prokurorit të
2 Specializuar, do të jap një urdhër me gojë.

3 ZPS-ja ka kërkuar leje nga Trupi Gjykses, me emailin e
4 datës 11 maj 2022, në orën 9.10, të përdorë disa prova të reja
5 për kundrapyetjet e Dëshmitares 1700. Materiali është nxjerrë
6 menjëherë pasi është bërë kërkesa tetë minuta pas orës 9.00,
7 9.08.

8 Edhe Trupi Gjykses vëren se provat e nxjerra rishtazi
9 janë një material burim i hapur që nuk janë shumë të gjata
10 edhe janë përdorur janë mbledhur nga deklaratat që janë dhënë
11 ditët e fundit.

12 Rrjedhimisht, Trupi Gjykses vlerëson se ZPS-ja ka treguar
13 arsye të vlefshme që s'i ka treguar më herët, s'i ka nxjerrë
14 më herët, këto prova dhe autorizon ZPS-ja t'i përdorë në
15 pjesën e kundrapyetjeve të Dëshmitares së Mbrojtjes 1700, që
16 është parashtrim i protokolluar 170.

17 Dhe me kaq mbyllet dhe urdhri me gojë i Trupit Gjykses.

18 Z. Prokuror, mund të vazhdoni me kundrapyetjet.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
20 Gjykatës. Mirëdita.

21 Pyetje nga të palës tjetër z. Michalczuk:
22 Py. Mirëdita, znj. Kaci. Shpresoj që po e shqiptoj mirë
23 mbiemrin tuaj. Unë jam përfaqësuesi i Prokurorisë që do t'ju
24 bëj ju pyetje. Dhe do ju lutesha të fokusoheni, të
25 përqendroheni te pyetja dhe kur të përgjigjeni të

1 përqendrohemi tek përgjigja, mos e zgjeroni përgjigjen, mos e
2 shtjelloni shumë. Sepse nëse ndodhë kjo unë do ju kërkojë të
3 përqendrohemi vetëm tek pyetja. Nëse jam i interesuar të marrë
4 më shumë informacion, do ju kërkoj unë të jepni më shumë
5 informacione dhe kjo është e rëndësishme për procedurat por
6 dhe që ta kuptoj sa më mirë Trupi Gjykses çfarë po thoni ju në
7 dëshminë tuaj.

8 Është e qartë kjo, znj. Kaci?u?

9 Pë. Do të ishte mirë Canolli, se nuk je tuj shqiptu mirë
10 mbiemrin.

11 Py. Do bëj të pamundurën, znj. Canolli.

12 Do të doja të filloja me qartësimin e disa aspekteve të
13 dëshmisë suaj që dhatë sot paradite. Sot na treguat, na thatë
14 që keni qenë anëtare e njësisë guerilja e Prishtinës. Thatë se
15 emri i këtij njësi i ishte BIA. Dhe këtë e keni thënë në faqen
16 35, rreshtat 12 deri në 13 dhe në faqen 37, rreshtat 4 dhe 8.

17 Saktë, kështu është, keni qenë në të vërtetë anëtare e
18 gueriljes së Prishtinës e njohur ndryshe si BIA?

19 Pë. Po.

20 Py. A mund t'i thoni Trupit Gjykses ose kësaj Gjykate që kur
21 keni qenë anëtare e këtij njësi?

22 Pë. Në listat e ushtrisë, figuroj nga 13 marsi i vitit 1998,
23 atëherë kur kam fillu kontributin tim pranë doktoreshës Flora
24 Brovina.

25 Py. Po cilës listë po i referoheni?

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
2 Dëshmitare, sepse kemi pjesën e kundrapyetjeve tani nga
3 Prokuroria e Specializuar në anglisht, problemi i përkthimit
4 për personat që flasin në anglisht, domethënë, nuk ka problem,
5 nuk ka më problem për përkthimin. Kështu që, në këtë situatë,
6 nuk është nevoja që të prisni që pohoj unë me kokë që të
7 flisni. Tani ka rëndësi që ju të kuptoni çdo gjë në shqip.
8 Kështu që mund të përgjigjeni pa qenë nevoja të prisni më,
9 pra, mjaft që të dëgjoni përkthimin dhe të përgjigjeni
10 menjëherë pas përkthimit.

11 Tani mund t'i përgjigjeni pyetjes së z. Prokuror.

12 DËSHMITARJA: Do të thotë gjatë vitit 1998 dhe fillimit të
13 1999, unë kam kontribu në Prishtinë. Prishtina -- guerilja ka
14 qenë në kuadër të Prishtinës.

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

16 Py. Po. Pyetja ime ishte: Ju përmendët listat, përmendën një
17 listë që keni qenë në një listë. Për cilën listë e keni
18 fjalën?

19 Pë. Në listat e përgjithshme të Ushtrisë së Përgjithshme të
20 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Lista e përgjithshme e krejt
21 ushtrisë.

22 Py. E keni fjalën për listën e Organizatës së Veteranëve? Për
23 këtë listë po flisni të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës pra?

24 Pë. Po.

25 Py. Pra, me sa kuptoj unë, keni statusin e veteranes të

1 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovë; saktë?

2 Pë. Po.

3 Py. Na thatë në atë listë jeni si person që ka qenë anëtar i
4 UÇK-së që nga 13 marsi i 1998. Por, në fakt, pyetja ime ishte
5 më shumë për anëtarësinë e BIA-s. Prej kur ishe anëtare e
6 njësimit BIA që nga cila kohë?

7 Pë. Nuk kemi listë definitive, po nga janari i vitit 1999,
8 kur kemi fillu kontributin dhe organizimet me z. Salih
9 Mustafa.

10 Py. Pra, për ta qartësuar këtë pjesë. Ju u bëtë anëtare e
11 njësimit BIA nga janari i vitit 1999; kështu?

12 Pë. Po.

13 Py. Znj. Canolli, cila ishte pozita juaj në njësitin BIA?

14 Pë. Nuk kam pasë pozitë definitive. Kam pasë njëlloj
15 përgjegjësie për shëndetësi, shëndetin dhe mirëqenien e
16 ushtarëve, popullsisë civile, të plagosurve. Gjithçka çka i
17 takon shëndetësisë.

18 Py. Kur ndaluat, domethënë, që kur nuk ishit më anëtare e
19 njësimit BIA?

20 Pë. Pas përfundimit të luftës më nuk jam marrë me angazhime,
21 kam vazhdu jetën time private.

22 Py. Pra, qershor, gusht, shtator i 1999. Mund t'i thoni
23 muajin të paktën?

24 Pë. Në shtator.

25 Py. Sot dëshmuat se keni punuar me doktoreshën Flora Brovina

1 në klinikën e saj ë Prishtinë. Dhe kjo është në faqen 34 të
2 transkriptit, rreshti 5 dhe 6, dhe në faqen 37, rreshti 3;
3 kështu?

4 Pë. Po.

5 Py. A kishit ndonjë trajnim, a kishit ndonjë trajnim
6 mjekësor, përgatitje mjekësore?

7 Pë. Unë edhe gjatë shkollës së mesme, pjesën praktike e kam
8 kry në atë ordinancë, pasi që institucionet publike tona kanë
9 qenë të okupume. Dhe pas përfundimit të shkollës së mesme kam
10 vazhdu aty punën. Ka qenë fillimisht klinikë pediatrike,
11 pastaj është shfrytëzu edhe për kontrollimin e të ç'vendosurve
12 të luftës të cilët kanë jetu në Prishtinë.

13 Py. Flora Brovina, a ishte doktoreshë e UÇK-së?

14 Pë. Mendoj që po.

15 Py. A ishte doktoreshë e BIA-s?

16 Pë. Ajo ka qenë doktoreshë pa dallim të ushtarëve të
17 njësiveve apo brigadave.

18 Py. Sot në dëshminë tuaj - do të gjej edhe pjesën për ta
19 cituar - përmendët diçka lidhur me faktin se Flora Brovina dhe
20 Salih Mustafa punonin bashkë, ndanin përgjegjësitë. E mbani
21 mend që e thatë këtë?

22 Pë. Po.

23 Py. Çfarë nënkupton kur thua ndanin përgjegjësitë?

24 Përgjegjësitë për çfarë, për kë?

25 Pë. Në rast rrezikut në komunën e Prishtinës, pra, në ato

1 vendbanime, tërheqja e popullatës civile është dashtë të bëhet
2 në malësinë e Gollakut në të cilën pjesë z. Mustafa e ka pasë
3 përgjegjësinë e vet me i mbikëqyrë.

4 Py. Pra, Flora Brovina ndihmonte në këtë proces nga aspekti
5 mjekësor, shëndetësor, ndërsa z. Mustafa ofronte ndihmën e
6 vet, asistonte nga aspekti logjistik, pra, evakuonte personat?
7 Këtë po thoni?

8 Pë. Po mendoj.

9 Py. Flora Brovina a u arrestua në ndonjë moment gjatë luftës?

10 Pë. Pas ofensivës së prillit - nuk e di ditën saktë -
11 doktoresha Flora Brovina është arrestu në banesën e saj në
12 Bregun e Diellit.

13 Py. Kush ishte personi përgjegjës për aspektin mjekësor për
14 gueriljen BIA pasi u arrestua ajo, kush ishte pastaj
15 përgjegjës?

16 Pë. Mendoj atë përgjegjësi e mora unë detyrimisht.

17 Py. Thoni se pasi u arrestua Flora Brovina, ju u bëtë personi
18 kryesor përgjegjës për aspektin mjekësor të njësitit BIA? Këtë
19 po thoni?

20 Pë. Nga data, nga dita që unë kam shku në guerilje shumë
21 përgjegjësi kam marrë. Ndërsa, pas arrestimit të Florës,
22 shumicën e gjënave e kam ditë që duhet me i krye.

23 Py. Pyetja në fakt, ishte disi më ndryshe. Pasi u arrestua
24 ajo, ju a ishit pastaj personi kryesor përgjegjës për aspektin
25 shëndetësor, mjekësor për njësitin BIA?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Ibadete Canolli-Kaçiu (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk

Faqe 63

1 Pë. Jo, s'kam pasë përgjegjësi të tillë. Jam mundu me ju
2 ndihmu.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshiroj
4 t'i tregoj dëshmitares si dhe palëve këtu disa dokumente, një
5 dokument që ka lidhje me këtë aspekt. Me lejen e Trupit
6 Gjykues.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Znj. Sekretare e Gjykatës,
9 dëshiroj që të shfaqim në ekran një dokument që ka numrin ERN
10 SPOE00325986, ZPS000325998 [sipas përkthimit]. Dhe është faqja
11 3.

12 Të nderuar Gjykatës, për informacionin tuaj, ky është
13 artikulli që është botuar online në faqen e internetit
14 www.histori.com më 20 maj 2021 dhe e ka titullin "Gratë e UÇK-së
15 - Historitë e parrëfyera".

16 Nëse mund ta nxjerrim në ekran. Këtu është versioni në
17 shqip, po mund ta nxjerrim dhe anglishten që ka të njëjtin
18 numër rendor, thjesht që ka ET në fund.

19 Znj. Canolli, a ju kanë intervistuar për këtë artikull?

20 Pë. Po. Por ky është një artikull i gazetar amatoresk. Do të
21 thotë, që e kanë përpunu në mënyrën qysh ata kanë dashtë dhe
22 me u shprehë. Do të thotë, unë, në njëfarë mënyre, i kam
23 marrë disa përgjegjësi, po jo pozitë përgjegjëse e
24 detyrueshme.

25 Py. Kuptoj. Por dua të përmend specifikisht atë pjesën e

1 artikullit që kemi nxjerrë këtu në ekran.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dhe dua ta lexoj. Është shumë e
3 shkurtër.

4 Py. Është një fotografi këtu, që besoj se jeni ju. Apo jo
5 znj. Canolli?

6 Pë. Po.

7 Py. Diçitura thotë:

8 "Pjesë e këtij njësitit ishte edhe Ibadete Canolli-Kaçiu,
9 e cila kishte filluar aktivitetin si stazhiere e infermierisë
10 tek Flora Brovina duke ndihmuar në zonat e prekura nga lufta.
11 Parashtrim arrestimit të Flora Brovinës, Ibadetja do të bëhej
12 përgjegjëse për shëndetësi në njësitin gueril BIA".

13 Pyetja ime është përsëri, përsëris pyetjen për ju: A
14 ishit ju pas arrestimit të Flora Brovinës, personi kryesor
15 përgjegjëse për shëndetësinë në njësitin BIA?

16 Pë. Mendoj që po. Por nuk ka pasë shumë ofensiva mbas
17 arrestimit të Florës. Kanë qenë disa trajnime të thjeshta.

18 Py. Ju thatë që Flora Brovina u arrestua në prill? E kam
19 kuptuar qartë në prill ishte?

20 Pë. Nuk e di saktë datën, pas ofensivës së prillit, sigurisht
21 ka qenë. Unë e kam kuptu ma vonë mbasi që është kry ofensiva
22 dhe na s'kemi pasë lajme. Ma vonë e ka kuptu prej informatave
23 që doktoresha Florë është arrestu. S'kemi pasë mjete
24 informative.

25 Py. A i keni dhënë deklaratë Mbrojtjes më 20 [sipas

1 përkthimit] mars 2021 për këtë çështje? 7 mars - më falni.

2 Pë. Po. Por këtë nuk më kanë pyet. Për këtë përgjegjësi nuk
3 më kanë pyet.

4 Py. A keni thënë të vërtetën në atë deklaratë që keni dhënë
5 Mbrojtjes?

6 Pë. Po.

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshiroj
8 ta heqim këtë dokument nga ekрани dhe të nxjerrim një dokument
9 tjetër që është deklarata e Mbrojtjes, deklarata që i ka dhënë
10 Mbrojtjes Ibadete Canolli-Kaciue e datës 27 mars 2021. DSM00148
11 deri në DSM00160, faqja 5.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
13 arsyeja pse doni që ta diskutoni këtë pjesë?

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Thjeshtë dua t'i rikujtoj diçka
15 dëshmitares që ka thënë për periudhën, për kohën kur është
16 arrestuar Flora Brovina që, në fakt, përputhet me kohën kur ka
17 marrë përsipër dhe ajo përgjegjësitë në njësitin BIA.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
19 rregull, vazhdoni.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund të nxjerrim versionin
21 anglisht. Do nxjerrim dhe shqipen, po, në fakt, është një
22 rresht shumë i shkurtër.

23 Py. Mund t'jua lexoj, znj. Canolli.

24 Pra, ju thatë i thatë Mbrojtjes si në vijim. Pyetja e
25 Mbrojtjes:

1 "A e keni parë ndonjëherë Flora Brovinën në Zllash?"

2 Dhe ju i jeni përgjigjur:

3 "Jo, po pas bombardimeve ajo u arrestua në apartamentin e
4 saj".

5 Kur filluan këto bombardimet që përmendni ju këtu, kur
6 filluan në Kosovë?

7 Pë. Nga 24 marsi i vitit 1999, unë doktoreshën Florë nuk e
8 kam taku më. Në ambulanten -- kur e kemi mbyllë ambulantën, më
9 nuk jam taku me të. Ditën e arrestimit nuk e di. E kam kuptu
10 pas ofensivës së prillit, domethënë, diku nga fillimi i majit.
11 Dhe nuk e di datën saktë kur është arrestu. Unë s'jam taku ma
12 me doktoreshën prej 24 marsit.

13 Py. E kuptoj këtë. Po në këtë deklaratën këtu qartë thoni që
14 ajo është arrestuar pas bombardimeve, të cilat kanë ndodhur më
15 24 mars dhe jo në prill të 1999?

16 Pra, e konfirmoni që ajo është arrestuar në mars dhe jo
17 më vonë apo doni të na thoni diçka tjetër?

18 Pë. Nuk e di datën kur është arrestu. Dita e fundit që unë
19 jam taku me doktoreshën ka qenë 24 marsi. Arrestimin e saj e
20 kam kuptu ma vonë. Dita e parë e bombardimeve ka qenë 24
21 marsi. Bombardimet kanë vazhdu edhe ma gjatë. Mirëpo dita e
22 parë ka qenë 24 mars. Atë ditë e kemi mbyllë ambulantën. Unë
23 më nuk e kam taku.

24 Py. Znj. Canolli, krahas detyrave shëndetësore që kishit në
25 UÇK, a ishit dhe ushtarë e UÇK-së?

1 Pë. Unë jam stërvit për mbrojtjen personale time dhe të
2 plagosurve. Nuk kam marrë pjesë në front. Kam dhënë veç
3 përgjegjësi shëndetësore.

4 Py. Gjatë luftës, sidomos mars prill të vitit 1999, a mbanit
5 uniformë ju, a vishnit uniformë?

6 Pë. Në mars jo. As gjatë ofensivës së prillit jo. Ndoshta ka
7 fundi i prillit ma kanë dhuru një uniformë, e kam pasë, po me
8 veshje civile kanë punu. Gjatë tërheqjes të plagosjes të
9 plagosurve dikun në 21 e kam pasë një uniformë ushtarake që ma
10 kanë dhuru. Bile, është shumë e madhe më ka ra. Po nuk kam
11 pasë as veshmbathje temet personale, kështu që e kam huazu dhe
12 e kam shfrytëzu gjatë atyre ditëve.

13 Py. Dakord.

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] A mund t'i kthehemi dhe njëherë
15 artikullit që pamë njëherë, fotografisë dhe artikullit që
16 pamë. që është përsëri dokumenti SPOE00325986 deri në
17 SPOE00325998, faqja 3 përsëri.

18 Py. Në këtë fotografi jeni ju, znj. Canolli apo jo? Është kjo
19 uniforma e UÇK-së?

20 Pë. Po. Kjo uniformë është e re e cila më është dhuru pas
21 përfundimit të luftës. Është hera e parë që e kam veshë gjatë
22 paradës së UÇK-së që kemi bë pas çlirimit nëpër qytetin e
23 Prishtinës. Ka qenë uniformë e papërdorur është hera e parë që
24 e kam vesh dhe e kam hala.

25 Py. Çfarë rrobash mbanit në prill të vitit 1999 kur ishit në

1 Zllash, çfarë veshje?

2 Pë. Zakonisht kam pasë fanerka të zeza, bluzë të zezë dhe kam
3 pasë një mantel të bardhë me krahë të shkurtra me u identifiku
4 që jam punëtore shëndetësore.

5 Py. Në prill të vitit 1999, a mbanit armë?

6 Pë. Ditët e ofensivës nuk kam pasë armë, ndërsa kur kemi
7 fillu transportin e të plagosurve më kanë dhënë një armë të
8 cilën e kam pasë për vetëmbrojtje dhe mbrojtjen e të
9 plagosurve në rast rreziku, por nuk e kam shkrep asnjëherë.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Me lejen e të nderuar Gjykatës,
11 do dëshiroja të shkonim pak më poshtë në të njëjtin artikull
12 që pamë më herët në ekran. Thjeshtë të zbresim pak më poshtë
13 në të njëjtën faqe. Shohim faqen tjetër. Tjetra ku është dhe
14 fotografia tjetër. Është një fotografi bardhë e zi. Kjo është
15 fotografia. Kjo është faqja 5, me sa arrij të dalloj.

16 Py. Znj. Canolli, e njihni këtë fotografi?

17 Pë. Po.

18 Py. A jeni ju në këtë fotografi?

19 Pë. Po, jam e dyta.

20 Py. Kjo fotografi tregon disa persona. Në të djathtë janë
21 katër burra rresht me armë, me pushkë dhe pastaj pas katër
22 burrave janë dy gra, dy vajza, dy gra. Njëra prej të cilave po
23 mban një pushkë. Jeni ju kjo, znj. Kaci, e dyta në të majtë
24 të kësaj foto?

25 Pë. Po është një armë e shkurtë.

1 Py. Çfarë arme ishte kjo?

2 Pë. Nuk më kujtohet emri, mendoj që ka qenë një Hekler
3 gjerman. Po unë thashë nuk kam shkrepë e kam pasë për
4 vetëmbrojtje, por nuk e ka shkrepë asnjëherë. Kjo fotografi
5 është bë pak para përfundimit të luftës në fshatin Sharban.
6 Kur kemi pasë mundësi edhe me bë na një fotografi.

7 Py. Po gruaja tjetër në fotografi kush është?

8 Pë. Në fakt në këtë fotografi janë dy gra. Nuk janë katër
9 burra. I dyti në fillim është Rusta, më ka ndihmu shumë në
10 shërbimet mjekësore. Pas tij është Linda. I treti nuk më
11 kujtohet. Jam unë dhe është Eminia, gruaja e Ismailit ka qenë
12 veç 17 --

13 Py. Më falni. Dhe njëherë e marrim nga e djathta në të majtë.
14 Nëse mund të na japësh edhe identitetet e atyre ushtarëve.

15 E fillojmë nga personi i parë në të djathtë. Si e ka
16 emrin ai?

17 Pë. I pari nuk shihet në fotografi.

18 Py. I dyti atëherë.

19 Pë. I dyti Rrusta.

20 Py. Emrin ,mbiemrin? Si e ka emrin dhe mbiemrin?

21 Pë. Veç Rrusta e ka emrinm mbiemrin s'po më kujtohet. Veç më
22 ka ndihmu shumë gjatë transportit të plagosurve.

23 Py. A ishte ai anëtar i njësitit BIA?

24 Pë. Po.

25 Py. Personi i tretë?

- 1 Pë. Personi i tretë është Linda. Është e familjes së Medis
2 Plakut. Nusja e djalit.
3 Py. Mbiemrin si e ka?
4 Pë. Lindita Asllani.
5 Py. A ishte dhe ajo anëtare e njësimit BIA?
6 Pë. Nuk e di. E kam taku ma vonë.
7 Py. Personi i katërt?
8 Pë. Personi i katërt nuk më kujtohet. Nuk e identifikoj.
9 Py. Por në këtë moment që është bërë fotografia ka qenë
10 anëtarë edhe ai i njësimit gueril BIA?
11 Pë. Kjo është bë në fund të luftës në Sharban. Atëherë
12 ushtarët kanë qenë të përzim prej gjithë anëve. Nuk janë
13 definu ky ushtar i BIA-s, ky i brigadës ky -- kemi qenë të
14 gjithë bashkë. Nuk e di postin ose njësinë ku ka vepru.
15 Py. Pastaj personi tjetër jeni ju vetë. Dhe e fundit në
16 fotografi si quhet?
17 Pë. Emine Vitia Brahimi.
18 Py. Ishte anëtare e BIA-s?
19 Pë. Po ishte bashkë me bashkëshortin e saj.
20 Py. Si e quanin bashkëshortin e saj?
21 Pë. Ismail Brahimi.
22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nën këtë
23 fotografi ka një diçiturë të fotografisë dua që ta lexoj.
24 Thotë:
25 "Ibadetja, vetë thotë, se ka pasur njohuri rreth revoles

1 po për pushkë automatike dhe për granatën e dorës është
2 trajnuar nga bashkëluftëtarët e saj".

3 A është e saktë kjo, znj. Canolli?

4 Pë. Po më kanë shpjegu qysh përdoren, s'e nuk kam ditë ma
5 herët.

6 Py. Znj. Canolli, folëm për BIA-n, kush ishte komandat i BIA-
7 s?

8 Pë. Në atë kohë nuk e di, po mandej e kam kuptu që ka qenë z.
9 Salih Mustafa.

10 Py. Kur e keni kuptu se ishte Salih Mustafa komandanti i
11 njësitit BIA?

12 Pë. Unë e kam ditë që ka pasë një pozitë udhëheqëse, po gjatë
13 transportit të plagosurve më datën 21 prill, z. Mustafa ka
14 qenë i veshur me uniformën ushtarake edhe gjatë tanë kohës e
15 kanë ditë që nën udhëheqje të komandant Calit do të
16 transportohen të plagosurit për në fshatin Majjac.

17 Py. Pra, ju e dinit që ai ishte komandant i BIA-s - më falni
18 - e mësuat që ishte komandant i BIA-s më 21 prill të vitit
19 1999; kështu?

20 Pë. Po pozitën e tij komanduese. Pozitë udhëheqëse e kam ditë
21 po jo si komandant.

22 Py. Dhe nga çfarë thatë - dhe më korrigjoni nëse e kam gabim
23 - ju thatë që njerëzit po thoshin që Salih Mustafa ishte
24 komandanti i këtij njësitit. Kështu e thatë?

25 Pë. Jo. Njerëzit e rëndomtë. Ushtarët, kur i kam pyetë qysh

1 ke me u transferu, kanë thënë nën udhëheqjen e komandat Salih
2 Mustafës, kemi me i çu të plagosurit në fshatin Majac. Do të
3 thotë Salih Mustafa ka qenë përgjegjës për sigurimin e rrugës
4 që na me vazhdu.

5 Py. Ju kuptoj. Do t'i kthehemi evakuimit më vonë.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ndërkohë të nderuar Gjykatës,
7 dua t'i tregoj dëshmitares një fotografi ku duket Salih
8 Mustafa dhe për këtë dua t'i bëj disa pyetje dëshmitares.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
10 të vazhdoni.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Është i njëjti artikull online.
12 I datës 20 maj të vitit 2021. Me numër ERN SPOE00325986 deri
13 në SPOE00325998. Është faqja 1. Nuk ka nevojë të tregojmë
14 versionin në anglisht. Mjafton versionin në shqip.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
16 të vazhdomë dhe kështu.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ju kërkohet ta zmadhojmë këtë
18 fotografi.

19 Py. E njihni këtë fotografi, znj. Canolli?

20 Pë. Po. Edhe kjo është ba atë ditë që kemi bë marshimin nëpër
21 rrugët e Prishtinës pas çlirimit.

22 Py. Në ç' datë?

23 Pë. Nuk e di saktë. Këto fotografi i kam siguri mbasandaj
24 prej fotografëve. Po është bë në stadiumin e qytetit të
25 Prishtinës.

1 Py. Po, po kjo parada, që po thoni, të paktën muajin dhe
2 vitin e paradës dhe të fotografisë?

3 Pë. Mendoj qershori i vitit 1999. Data s'muj me e definu
4 saktë.

5 Py. Salih Mustafa është në këtë fotografi?

6 Pë. Po. Është afër meje. Ky me kapelën e kuqe.

7 Py. Pra, është në mes të fotografisë një person me kapelë të
8 kuqe dhe ju po thoni që ky është Salih Mustafa. Personi përbri
9 atij jeni ju. A mund t'i thoni Gjykatës në cilën anë të Salih
10 Mustafës jeni ju në këtë fotografi, pra, në raport me Salih
11 Mustafën, ku jeni ju këtu në fotografi?

12 Pë. Jam në anën e majtë. Kam shiqimin përpjetë.

13 Py. Mos e keni vënë dhe ju dorën mbi supin e Salih Mustafës?

14 Pë. Jo, nuk është dora ime. Është dora e këtyne lart.

15 Py. Kush janë këta personat e tjetër në fotografi?

16 Pë. Disa i njoh, disa nuk i njoh. Këtu është Shyhrete

17 Gosalci, pastaj Salih Mustafa, jam unë. Ky në qoshe është

18 Bashkimi. Të tjerët nuk i njoh.

19 Py. Bashkimi si e ka mbiemrin?

20 Pë. Nuk ja di.

21 Py. Këta personat në fotografi janë anëtarët e njësitit BIA?

22 Pë. Jo, nuk janë të gjithë. Janë ushtarë edhe të njësiteve të
23 tjera. Dhe se ka qenë komplet zona operative e Llapit e ka dhe
24 civilë të cillët ju kanë bashkangjitur fotografisë. Që këtu po
25 shoh edhe një fëmijë.

1 Py. Të flasim tani sesi njiheshit ju me Salih Mustafën. Mund
2 t'u thoni Gjykatësve, prej sa kohe, pra, që kur e njiheshit ju
3 me Salih Mustafën?

4 Pë. Ndoshta prej fillimit të vitit 1999. Në ordinancën e
5 Flora Brovinës, ju thashë, aty jam taku edhe me z. Salih
6 Mustafa edhe me Isa Kastratin. Këta dy i kam taku tanë kohën
7 aty. Ata i kanë bërë bisedimet me doktoreshën Florë por
8 nganjëherë kam qenë edhe unë aty.

9 Py. Pra, takimet, siç e kuptova, kanë ndodhur në klinikën, në
10 ordinancën, pra, të Flora Brovinës në Prishtinë; këtë po
11 thoni?

12 Pë. Po. Po.

13 Py. Dhe herën e parë që jeni njohur me Salih Mustafën, ka
14 qenë janari i vitit 1999 në atë klinikë; kështu?

15 Pë. Mendoj që ka qenë janari, se ka qenë koha e ftohtë. Po
16 nuk mundem saktë muajin, veç që unë e kam taku disa herë Salih
17 Mustafën jo veç një herë.

18 Py. Po tani çfarë raporti, çfarë marrëdhënie keni me Salih
19 Mustafën? Si do ta përshkruanit?

20 Pë. Ka qenë ish i burgosur politik. Që ka kontribu shumë për
21 vendin e vet. Ka kontribu shumë për popullatën civile. Ka
22 kontribu çdo gjë ka dhënë nga vetja për lirinë e vendit tonë.
23 Pas luftës jo që kam rujtë shumë kontakte, jo veç me z.
24 Mustafa, po as me anëtarë të tjerë. Disa që i kam pasë në
25 familje. Unë ju kam kthyer jetës time të përditshme. Kam kriju

1 familje, kam kriju karrierë edhe nuk i kam ruajtë kontaktet me
2 të.

3 Py. Pas luftës, jeni takuar në ndonjë rast; nëse po, me
4 ç'raste?

5 Pë. Jo. S'jam taku. Përveç këtë ditën që kemi bë marshimin
6 unë jam tërhek. Nuk kam ruajtë kontakte me të tjerë. Ju kam
7 kthy krejt jetës sime private.

8 Py. Znj. Canolli, ishit anëtare e BIA-s. Roli, funksioni juaj
9 ishte kryesisht një funksion mjekësor, shëndetësor, po mbanit
10 dhe armë. Z. Salih Mustafa ishte komandat i njësisë suaj, pra,
11 që, që i bie të ketë qetë komandant i juaj?

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shoh
13 që znj. Dëshmitare pohon me kokë. Ta interpretojë që po thoni
14 "po" me këtë lëvizje të kokës

15 DËSHMITARJA: Po.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
17 them këtë për procesverbalin që të shprehet me fjalë.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit shumë.

19 Py. Atëherë, ai mund t'ju jepte juve urdhra?

20 Pë. Nuk kam marrë asnjëherë urdhër.

21 Py. Nuk po ju pyes a keni marrë urdhër prej tij. Ajo që
22 përpiqem të kuptoj prej jush, është që, siç e pranuat dhe ju
23 vetë, është që ju vetë ishit anëtare e BIA-s. Ai ishte
24 komandanti njësitit BIA.

25 Pyetja ime ishte kjo: A ishte ai në gjendje, pra, me

1 cilësinë e tij si komandant, t'ju jepte juve urdhra? Pra, a

2 mund t'ju jepte ai juve urdhra?

3 Pë. Ai mund të më jepte urdhra dhe unë do t'i zbatoja. Është
4 një detyrë e të gjithë ushtarëve kudo në botë.

5 Py. Po a ishte ai në gjendje që, pra, a mund të jepte ai
6 urdhra anëtarëve të tjerë të njësitit BIA?

7 Pë. Me këtë pyetje nuk mundem me ju përgjigj se nuk pa tu
8 urdhnu dikënd ose tu bë diçka. Gjatë kohës sa unë kam qenë në
9 Zllash kam pa gjak, kam ndi krisma, kam pa të plagosur e të
10 smut, nuk kam pasë kontakte. Gjatë transportit me z. Mustafa
11 jemi taku disa herë kur ky e ka vëzhgu rrugën na kemi shku
12 mbrapa atij. Po.

13 Py. Dua t'ju bëj disa pyetje pikërisht për këtë. E cekët
14 evakuimin sot më herët. E kemi në faqen 44, rreshtat nga 18
15 deri në 22. Kur thatë që u takuat për herë të parë me Salih
16 Mustafën në Zllash më datë 21 prill, kur po bëhej evakuimi i
17 të plagosurve. Kështu?

18 Pë. Po.

19 Py. Cili ishte roli i Salih Mustafës në evakuimin e të
20 plagosurve?

21 Pë. Sigurimi i një rruge sa më të sigurtë për transportin e
22 të plagosurve deri në fshatin Majac. Ka qenë përgjegjës për
23 sigurimin e rrugës që ne kemi pasë me ndjek.

24 Py. Ai vetë po e bënte evakuimin apo po bënte mbikëqyrjen e
25 evakuimit? Si do ta përshkruanit ju vetë rolin e tij? Si një

1 koordinator apo si një person që po e bënte, po e realizonte
2 po zbatonte vetë, apo të dyja?

3 Pë. Ai ka bërë mbikëqyrjen. E ka vëzhgu rrugën. Ka shku para
4 neve. Mandej na kemi vazhdu. Dhe çdo herë kur ne kemi mbërri
5 në atë pikë, ai ka qenë aty tu na pritë. Sa herë jemi ndalë ai
6 ka qenë aty tu na pritë. Domethënë, ai ka shku ma herët për me
7 siguru terrenin.

8 Py. Siç thatë ju që po e koordinonte, bashkërendonte, këtë
9 evakuim a e keni dëgjuar apo e keni parë që të jepte urdhra,
10 udhëzime, orientime, dikujt?

11 Pë. Gjatë transportit kam qëndru në kerr me një plagosur që a
12 kanë ma randë deri aty ku ka shku kerri ka qenë një ushtarë i
13 cili ka qenë në boshtin kurrizor i plagosun, nuk kam pasë
14 shumë mundësi me i ndëgju bisedat e tyre. Po ky ka qenë
15 vëzhgim.

16 Py. Pra, nga larg, nga distanca, çfarë patë me saktësi, për
17 Gjykatësit mund ta thoni? Po përpiqem, ajo që po përpiqem të
18 kupto, që të mos ju ngatërroj -- ajo që po përpiqem të kuptoj
19 është që nëse e keni parë, qoftë edhe nga larg, apo nëse e
20 keni dëgjuar Salih Mustafën që të jap urdhra, drejtime,
21 orientime. Se urdhri mund të jetë dhe verbal me gojë
22 domethënë. Për shembull, mund të jetë që edhe që t'ia tregojë
23 me trup.

24 Pë. Ka bërë dhe me lëvizje, edhe me gojë. Më , një prej
25 ushtarëve ka qenë alergji me një lloj bari edhe ai -- unë kam

1 dashtë me i dhënë antibiotik se plaga ka fillu me ju infektu
2 dhe më ka thënë mos më jep atë barin që është ai alergji. Aty
3 u afru z. Mustafa dhe e ka pyetë a ka diçka të paqartë, a ka
4 ndonjë problem? I shpjegova që është alergji, Avnia, një bari
5 dhe po shpjegon atë barin mos ma jep se mund me më shkakto
6 shokanfilaktik. Jo diçka tjetër. Është mundu çdo herë me na
7 qenë afër.

8 Py. Po por na thatë që gjatë evakuimit thatë se patë diçka
9 nga largësia. Kështu çfarë deshët të thoshit me këtë?

10 Pë. Me një udhëkryq ku jemi ndalë, z. Mustafa na ka thënë që
11 kemi -- ata kanë pa që kanë bë me dorë që kemi me vazhdu lart.
12 Po nuk më ka thënë mu, po ju ka thënë atyre shoferave dhe
13 njerëzve tjerë. Jo definitiv diçka me mu.

14 Py. Ju kuptova. Faleminderit.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
16 Prokuror, më lejoni t'i bëj një pyetje pa ju ndërhyrë shumë në
17 kundrapyetjet tuaja.

18 Cekët se Salih Mustafa ishte mbikëqyrës gjatë evakuimit.
19 Ju kuptova saktë?

20 DËSHMITARJA: Po.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Çfarë
22 doni të thoni ju me këtë fjalën "mbikëqyrje"? Sepse ose më
23 saktë t'ju shpjegojë si e kuptoj unë fjalën "mbikëqyrës" e
24 mund të më korrigjoni ju pastaj nëse e kam kuptuar gabim.
25 Mbikëqyrësi është personi i cili drejton, ka nën kontroll,

1 pra, komandon dhe organizon një evakuim. Unë nuk e kuptoj pse
2 tani po më thoni që: Nuk pashë gjë, nuk di gjë, po ndërkohë
3 mund të thoni që ishte mbikëqyrësi. Se këtu duhet thënë e
4 vërteta, ju lutem të jeni diçka më e qartë lidhur me këtë.

5 Shikoj që është hequr fotografia, por desha t'ju bëja
6 edhe një për fotografinë.

7 Gjithsesi mund të flisni tani.

8 DËSHMITARJA: Po unë e thashë që ka pasë përgjegjësi për
9 mbikëqyrje dhe sigurimin e rrugës. Nuk e mohova atë. Ai ka
10 qenë përgjegjësi, mbikëqyrësi dhe e ka siguri rrugën.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Se u
12 përdor fjala "mbikëqyrës", "mbikëqyrësi" çfarë doni të thoni
13 me këtë?

14 "Ai ishte mbikëqyrësi. Kontrollonte rrugën, na drejtonte,
15 shkonte përpara nesh. Dhe sigurohej që rruga të ishte e
16 pastër".

17 Ai koordinonte, bashkërendonte këtë evakuim.

18 Çfarë doni të thoni me këtë ju që "bashkërendonte
19 evakuimin"?

20 Pra, pyetja ime është kjo: Si mund të koordinosh,
21 bashkërendosh pa u thënë njerëzve pa u diktuar atyre se çfarë
22 të bëjnë

23 DËSHMITARJA: Aty ka pasë dhe ushtarë të tjerë, do të
24 thotë, ai me ata të cilët kanë transportu të plagosurit në
25 krahë, në dorë dhe aty ai e ka siguru rrugën. Na kemi vazhdu

1 pas tyne. Këtë deshta me thënë. S'di sa jam e qartë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
3 është fare e qartë për mua tani, se nuk -- pra, "ai po e
4 bashkërendonte këtë evakuim". Në faqen 70, rreshti 10.

5 Çfarë doni të thoni me këtë që "po e bashkërendonte
6 evakuimin"

7 DËSHMITARJA: Do të thotë, ai nuk ishte vetëm. Kishte dhe
8 ushtarë të tjerë të cilët ndihmojnë në këtë drejtim. Na kemi
9 pasë transportin e të plagosurve me shku në Majac ku a kanë
10 spitali i specializum për intervenime ma të thella. Atje e
11 kemi pasë me i çu të plagosurit.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Fjala
13 "bashkërendoj" do të thotë që së bashku dhe me të tjerë
14 sigurisht, por ti si person kryesor u thua të tjerëve se ç'të
15 bëjnë. Këtë bën bashkërenduesi.

16 Prandaj nuk e kuptoj sqarimin tuaj për fjalën
17 "bashkërendim", po ju kuptova çfarë thatë. E dëgjova çfarë
18 thatë. Po e lëmë me kaq këtë temë.

19 Z. Prokuror, kam dhe një pyetje që dua të bëj për
20 fotografinë dhe pastaj mund ta largojmë fotografinë.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Patjetër.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
23 Dëshmitare, përbri me z. Mustafa, pra, ngjitur me të, në të
24 djathtë, ju na shpjeguat që ju në të majtë por dhe me
25 vështrimin lart, duke këqyrur lart, por personi që është

1 djathtas tij e njihni kush është ajo?

2 DËSHMITARJA: Është Shyhrete Gosalci. Ka qenë edhe kjo
3 ushtare.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është
5 dhe një grua mbrapa, menjëherë mbrapa tij, pra, pas z.
6 Musstafa. E njihni kush është ajo? Dhe nëse nuk është e qartë
7 - nëse znj. Sekretare mund ti -- znj. Asistente e sallës t'i
8 jap dëshmitares një laps për t'u siguruar që po shënon të
9 njëjtin person. Personi që është në -- po. Pikërisht ju
10 vendosët një pikë blu, një shenjë të vogël blu. Kush është ai
11 person?

12 Pë. Edhe kjo ka qenë ushtare po nuk më kujtohet emri. Ka
13 qenë gjatë kohës aty.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
15 mirë. Dhe përbri, në të majtë të saj, të këtij personit që ju
16 e shënuat me këtë shenjën e kaltër, mbase mund ta shënoni me
17 një rreth këtë personin tjetër që është në të majtë të saj.
18 Po, për këtë. E dini kush është?

19 DËSHMITARJA: Edhe kjo ka qenë ushtare. Meida.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por
21 nuk ja dini emrin?

22 DËSHMITARJA: Menda. Menda.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
24 ndonjë emër më të gjatë sesa thjeshtë Menda.

25 DËSHMITARJA: Nuk mundem me kujtu. Ndoshta Mendua.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,
2 të vendosim numrin 1, këtu. Shënoheni me 1. Se është më e
3 lehtë, personi që është më në të djathtë të këtij personi mund
4 ta shënoni me numrin 2. E njihni kush është?

5 DËSHMITARJA: Jo, nuk i njoh të tjerët. Nuk i njoh. Janë
6 ushtarë të gjithë zonës operative të Llapit. Ndoshta dhe nuk
7 janë ushtarak hiç, po kanë siguru uniforma dhe atë ditë i kanë
8 vesh për praje.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Thjeshtë t'ju pyes. E shënuat këtë pësonin që qëndron mbrapa
11 z. Mustafa me një shenjë të vogël ngjyrë të kaltër. Mund të
12 shënoni 2, numrin 2 aty dhe ta përsërisni dhe emrin e atij
13 personi?

14 DËSHMITARJA: Emri nuk më kujtohet. Veç e di që ndërkohë
15 e kam taku, në cilën pjesë e kam taku, po e kam taku gjatë
16 luftës. Emri nuk më kujtohet.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ka
18 ndonjë grua tjetër në këtë fotografi të cilën e njihni?

19 DËSHMITARJA: Është Shyhretja që ju thashë këtu.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.
21 Numri 1.

22 DËSHMITARJA: Numri 1, Menda. Kjo, nuk e di emrin. Numër 3
23 po vendosi.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
25 ndonjë person tjetër në fotografi, ndonjë grua?

1 DËSHMITARI: Besoj ky djali këtu. Të tjerat nuk i njoh.

2 Këto nuk i njoh. Dhe ky djali këtu?

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Grua?

4 Më interesojnë vetëm gratë.

5 DËSHMITARJA: Nuk i njoh.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Faleminderit. Faleminderit për përpjekjen.

8 Z. Prokuror, vazhdoni ju lutem.

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit shumë, të nderuar
10 Gjykatës.

11 Py. Znj. Canolli, t'i kthehemi çështjes së bashkërendimit. E
12 kemi në faqen 71, rreshtat 9 deri në 12. Thatë se:

13 "Në një prej kryqëzimeve ndaluar, pashë z. Mustafa që po
14 ja bënte me dorë që mund të vazhdonim drejtë. Jo se po
15 komunikonte me mua, por kjo shenjë ishte drejtuar shoferëve".

16 Kështu?

17 Pra, a e patë ju z. Sali Mustafa gjatë këtij evakuimi në
18 ndonjë situatë tjetër ku po i bënte gjeste të ngjashme të
19 tjerëve?

20 Pë. Jo. Unë gjatë tanë kohës dhe që u ndal na ka pyetë "Qysh
21 po kaloni? Qysh po ndihen të plagosurit? A keni nevojë për
22 diçka?"

23 Py. Dëgjuat nga dikush gjatë evakuimit, mbase dhe më vonë, që
24 ishte Sali Mustafa ai që po e bashkërendonte evakuimin?

25 Pë. Jo. Është mendim i jem. S'më ka thënë dikush.

1 Py. Po t'i ktheheni me mendje aso kohe kur e patë Salih
2 Mustafën gjatë evakuimit, mund t'ju thoni Gjykatësve, si ishte
3 i veshur Salih Mustafa, ç'veshje kishte?

4 Pë. Uniformën ushtarake me këtë kapelën e kuqe me emblemën e
5 UÇK-së.

6 Py. Kapela e kuqe që është dhe në këtë fotografi që kemi
7 përpara? E njëjta ose e ngjashme lloj kapele.

8 Pë. E ngjashme me këtë lloj. Ndoshta dhe kjo e ngjashme me
9 këtë lloj.

10 Py. Pra, kjo është beretë në fakt dhe jo kap, po e keni
11 fjalën për këtë beretën apo jo?

12 Pë. Për beretën.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund ta heqim këtë fotografi.
14 Faleminderit.

15 Py. Duke qenë se dhe ju vetë ishit anëtare e njësitit BIA,
16 dëshiroj t'ju bëj disa pyetje lidhur me disa anëtarë të tjerë
17 të BIA-s të cilët mund t'i njihni?

18 Zëvendësin e Salih Mustafës në njësitin BIA, e njihnit
19 kush ishte?

20 Pë. Nuk i di pozitat, po nëse me emra ose me fotografi m'i
21 pyet, i njoh disa. Pozitën zëvendësuese nuk e di kush e ka
22 pasë.

23 Py. E njihni një person që quhej Brahim Mehmetaj?

24 Pë. Nëse pyetem për periudhën gjatë luftës dhe para luftës,
25 nuk e njoh. Pas lufte, e di që ka qenë pjesë udhëheqëse dhe e

1 njoh. Kam pasë disa takime mes miqve, po jo personale. Nuk kam
2 afrimitet personal me të.

3 Py. Pra, pjesë e udhëheqjes e çfarë gjëje ishte z. Brahim
4 Mehmetaj?

5 Pë. Pas luftës e kam kuptu që ndoshta ka pasë ndonjë njësi të
6 vetën në kuadër të gueriljes, po gjatë luftës nuk e kam taku
7 asnjëherë dhe nuk e e kam dëgju si emër. Pas luftës, si krejt
8 ushtarët, kemi pasë gjatë paradës dhe tash ndonjëherë ndonjë
9 muhabet të përbashkët në rrjetet sociale.

10 Py. Për çfarë lloj mediash sociale e keni fjalën?

11 Pë. Po rrjetet sociale Facebooku. Na kemi miq të përbashkët.

12 Py. Ja njihni nofkën Brahim Mehmetajt?

13 Pë. Më duket Bimi.

14 Py. Kur jeni njohur për herë të parë me Brahim Mehmetajn?

15 Pë. Gjatë paradës. Janë disa fotografi që qarkullojnë nëpër
16 shumë media. Është edhe ai në ato fotografi. Po nuk e kam
17 njoftë atëherë mbasandaj e kam ditë që ky është Bimi. Se
18 atëherë nuk e kam njoftë. As gjatë paradës nuk e kam njoftë.

19 Py. Parada kur u zhvillua?

20 Pë. Në qershor, pas përfundimit të luftës.

21 Py. Po një person me emrin Bahri Gashi, e njihni?

22 Pë. Po e njoh. E kemi mik të familjes.

23 Py. Edhe ky ka qenë anëtar i njësitit BIA?

24 Pë. I njëjti në datën 21 mars, pra, ditën e transportit edhe
25 ky ka qenë me Salih Mustafën.

1 Py. E keni fjalën për prillin?

2 Pë. Ah, po. Kërkoj falje. 21 prill. Ditën e tërheqjes.

3 Py. Pra, po na thoni se ishte pjesë e grupit që mori pjesë
4 tek evakuimi apo jo?

5 Pë. Po.

6 Py. A e dini çfarë pozite kishte në njësitin BIA?

7 Pë. Jo. As nuk është deklaruar ai. As nuk e kam pyetë.

8 Py. Ja dini nofkën?

9 Pë. Bafta dhe tash e quajnë Bafta.

10 Py. Çfarë marrëdhënie keni aktualisht, nëse keni, me z. Bahri
11 Gashi?

12 Pë. Po kam raporte dhe tash. Kemi raporte miqësore ende
13 familjarisht. Kohët e fundit e ka pasë një problem shumë të
14 madh shëndetësor. E kam ndihmu në lidhje me operacionin që e
15 ka kry. Vërtetë shërimi i tij ka zgjatë goxha shumë. Gati dy
16 muj ka qëndru në spital i ka pasë dy intervenime të mëdhaja.

17 Py. E di që këto pyetje ua kanë bërë në fakt Avokatët
18 Mbrojtës, por sidoqoftë, unë do t'i bëj përsëri. Dhe arsyeja
19 pse po e bëj këtë pyetje, është se, sikurse e kuptuam sot, ju
20 na thatë që keni qenë gjatë luftës anëtare e njësitit BIA dhe
21 përpara kam disa emra që besoj që mund të kenë qenë anëtarë të
22 BIA-s?

23 Më lejoni të filloj me emrin Ilmi Vela?

24 Pë. Nuk e njoh.

25 Py. Po Ilmi Rakovica?

1 Pë. Nuk e njoh?

2 Pë. Nofka Vdekja ju thotë gjë në raport me BIA-n?

3 Pë. Jo.

4 Py. I keni dëgjuar këto emra Ilmi Velasj, Ilma Rakovica,
5 nofka Vdekja, në kontekstin gjatë kohës që u keni qenë anëtare
6 në aktivitetet tuaja me BIA-n?

7 Pë. Jo.

8 Py. Po personin me emër Nazif Musliu. E njihni këtë emër?

9 Pë. Jo, nuk e njoh?

10 Py. Po nofkën Tabuti? Gjithmonë në raport me anëtarësinë e
11 BIA-s?

12 Pë. Jo. Unë nuk mundem me i njoh të gjithë ushtarët. Ata të
13 cilët i kam pasë më afër, që më kanë ndihmu me të plagosur,
14 ndoshta emrin s'ia kujtoj, po me pa i njoh. Po për të plagosur
15 ndoshta muj me emën gjithsecilin me veçu. Po për ushtarët disa
16 i kam pasë më të afërt, sidomos do ma të rinj që më kanë
17 ndihmu shumë.

18 Py. Më lejoni t'ju jap disa emra të tjerë mbase ju ndihmoj.

19 Dardan ose Dardani? Ju thotë gjë në kontekstin e njësitit
20 BIA gjithmonë?

21 Pë. Nuk e kujtoj. Nuk e njohë. Nuk e kam dëgju.

22 Py. Emri, mbiemri Kujtim Qerimi? E njihni këtë person?

23 Pë. Jo.

24 Py. Personi me emër ose me nofkë Afrim? Në kontekstin e
25 anëtarësimit të BIA-s?

1 Pë. Nuk e njoh.

2 Py. Po personi me emrin ose me nofkën Fatmir?

3 Pë. Nuk e njoh.

4 Py. Po emri Avni?

5 Pë. ka qenë dy të plagosur Avni. Avni Gashi dhe Avni Haziri.

6 Dhe nuk e di a ka qenë ushtarë të njësitit gueril apo të

7 Brigadës 153, po të dytë i kam pasë në trajtim.

8 Py. A dini a kanë pasë ndonjë farë raporti, ndonjë farë

9 lidhje me njësitin BIA?

10 Pë. Nuk e di. Gjatë kohës kur i kam trajtu të dytë kanë qenë

11 të plagosur. Njëni ka qenë shumë rëndë. Njëni në këmbë.

12 Py. A mund t'i thoni Gjykatës, nëse i mbani mend, datat kur i

13 keni trajtuar këta dy të plagosur? A ka qenë prill 1999, gjatë

14 evakuimit? Më përpara? Më mbrapa?

15 Pë. Në prill 19, 20, 21 derisa i kam dorëzu në Majac i kam

16 pasë në trajtim.

17 Py. Në Zllash; apo jo?

18 Pë. Në Zllash.

19 Py. Po personi me emrin Bujar? Në kontekstin e anëtarësimit

20 të njësitit BIA?

21 Pë. Nuk e njoh.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në, po

23 mbase disa fotografi mund ta ndihmojnë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Vazhdoni, ju lutem.

1 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] A mund të vazhdojmë me

2 fotografitë, znj. Sekretare e Gjykatës? SPOE00222690.

3 Py. A njihni ndokënd në këto foto, znj. Canolli?

4 Pë. Mendoj që po.

5 Py. A mund të na thoni cilin njihni në këtë foto?

6 Pë. A mund ta definoj me laps?

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,

8 ju lutem vazhdoni. Dhe pastaj me numra. Shënojeni me numra se

9 është më mirë kështu, është më kollaj

10 DËSHMITARJA: Numri 1 është Salih Mustafa. Këtu e paska

11 një kapele të zezë. Ndërsa numri 2, sipër, është Fatmir Sopi.

12 Nuk e kam taku kurrë gjatë luftës. E kam taku gjatë aplikimit

13 të statusit të veteranit. Ka qenë zyra dhe e kam ditë që ky

14 është. Këta dy nuk i njoh.

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

16 Py. Ndokënd tjetër?

17 Pë. Nuk i njoh.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirë mund ta heqim këtë dhe të

19 nxjerrim një fotografi tjetër. Kjo fotografia e re është

20 SPOE00222600.

21 Py. E njëjta gjë. A njihni ndonjë nga këta në këtë fotografi?

22 Dhe, nëse po, shënoheni me numër dhe na thoni emrin e

23 personit, nëse e njihni, kuptohet.

24 Pë. Personi i parë këtu me numrin 1 është Bahri Gashi. I dyti

25 është Salih Mustafa. Të tretin nuk e njoh.

1 Py. Dhe unë ju them që mund të jetë Dardani, Kujtim Qerimi, a
2 ju thotë gjë, nëse e lidhni dot fytyrën me emrin, mbiemrin me
3 nofkën? Shikoheni nga afër.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] S'e zmadhojmë dot më shumë se
5 kaq në fakt.

6 Py. Po shikoheni pak me vëmendje, nëse ju thotë gjë.

7 Pë. Nuk e njoh. Nuk e kam taku.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në rregull. Shikojmë një
9 fotografi tjetër. SPOE00222642.

10 Py. Znj. Canolli, të njëjtën gjë. Merrni një laps, stilolaps
11 dhe shënoni me numër personin që njihni në këtë fotografi ose
12 personat më saktë.

13 Pë. Numri 1 prapë është Salih Mustafa. Numri 2 është Bahri
14 Gashi. Këta dy nuk i njoh.

15 Py. Kuptoj.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dhe fotografia e fundit. Kjo
17 fotografia është SPOE00222695.

18 Py. E njëjta gjë. Merrni një laps, stilolaps dhe shënoni
19 personat që i njihni dhe na thoni emrat.

20 Pë. Unë këtë në mes e njoh, veç z. Mustafa.

21 Py. Mirë, faleminderit.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund ta heqim këtë fotografi.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Faleminderit, znj. Asistente e Gjykatës.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

- 1 Py. A keni ndonjë vëlla, znj. Canolli? Keni vëllezër?
- 2 Pë. Po e kam një.
- 3 Py. Si e ka emrin vëllai.
- 4 Pë. Agim.
- 5 Py. A ka qenë edhe vëllai anëtar i njësitetit BIA?
- 6 Pë. Jo.
- 7 Py. A ka qenë në Zllash në vitin 1999?
- 8 Pë. Jo. Deri në fshatin Mramor a familja, ai është kthyer me
- 9 prind.
- 10 Py. A e njihni ndonjë person që quhet Halit Canolli?
- 11 Pë. Jo.
- 12 Py. Nuk është i afërmi juaj?
- 13 Pë. Jo. Fshati ku unë e kam prejardhjen është fshat me
- 14 territor më i madh në Kosovë dhe nuk njihna mes vedi. Unë kam
- 15 jetu në Prishtinë. Veç të afërmit shumë të afërt i njoh. Nuk i
- 16 njoh tjerët,
- 17 Py. Njihni ndonjë me nofkën Curi? Curi?
- 18 Pë. Jo.
- 19 Py. Nga meshkujt e familjes suaj, a ka qenë ndonjëri anëtar i
- 20 BIA-s përveç jush? Nga gjinia mashkullore, pra?
- 21 Pë. Jo, as nga gjinia femërore, as mashkullore.
- 22 Py. Znj. Canolli, gjatë këtij gjykimi, jo ti po të tjerët,
- 23 një nga dëshmitarët ka thënë që është edhe viktimë në këtë
- 24 çështje, tha që disa nga gratë që kanë qenë anëtare të UÇK-së
- 25 kanë marrë pjesë në keqtrajtimin e tij brutal, mizor në

1 Zllash. A dini ndonjë gjë ju për këtë?

2 Pë. Jo.

3 Py. Ju vetë a jeni përfshirë në keqtrajtimin e ndonjë personi
4 civil gjatë luftës?

5 Pë. Jo. Unë e kam dhënë një betim që kam me ju ndihmu
6 njerëzve. Edhe keqtrajtimi është ndëshkim ndaj punëtorit
7 shëndetësor.

8 Py. Përgjigja juaj është jo?

9 Pë. Jo. Jo.

10 Py. A njihni një person e emrin [REDAKTUAR]?

11 Pë. Jo.

12 Py. A dini gjë për [REDAKTUAR]?

13 Pë. Jo.

14 Py. A keni qenë ndonjëherë në fshatin [REDAKTUAR]?

15 Pë. Jo, asnjëherë.

16 Py. [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 Pë. Nuk mu kujtu si emën.

11 Py. Duhet ta thoni.

12 Pë. Po, po.

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR].

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a do bëjmë
13 pushim para se ta mbyllim seancën për sot apo do të
14 përfundojmë?

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Plani
16 është të vazhdojmë siç bëmë edhe dje. Planifikimi ynë është të
17 vazhdoj deri në orën 3.00, të bëjmë çerek ore pushim, pak a
18 shumë, do të ishte mirë ta mbaronim më herët tani dhe mund ta
19 bëjmë pushimin dhe në orën tre pa pesë dhe të vazhdojmë deri
20 në orën 4.00.

21 Nëse ka ngelur dhe pak dhe mund ta mbarojmë dëshminë e
22 dëshmitares sot, atëherë unë jam e gatshme të vazhdojë deri në
23 orën 4.15, përndryshe do vazhdojmë ditën e nesërme.

24 Po jua lë ju në dorë, nëse ju mendoni se është mirë ta
25 përmblihdni -- jo ta përmblihdni po ta ndërpresim tani të

1 bëjmë pushimin.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund të bëjmë pushim shumë të
3 shkurtër sepse në varësi të përgjigjeve të dëshmitares, mua më
4 duhet të ndryshojë pak linjën e pyetjeve. Mbase dhe ti
5 shkurtoj. Dhe mund të përfundojmë sot.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
7 mund ta bëjmë pushimin për pak minuta. Por kam nevojë për një
8 qartësim lidhur me fotografinë dhe, pastaj, z. Prokuror, mund
9 të bëjmë pushimin.

10 Znj. Sekretare e Gjykatës, fotografia e fundit që patëm
11 në ekran -- jo e fundit, po fotografia që kishte me artikullin
12 online të grave, të femrave të UÇK-së. SPOE325986. Nëse në mos
13 gaboj në këtë artikull në fund, e kemi fotografinë.

14 Thjeshtë për sqarim, për qartësim në faqen 73, rreshti
15 20, znj. Dëshmitare, unë besoj se mënyra si e kuptova unë - po
16 ju lutem më korrigjoni - është që gratë -- gruaja në të
17 djathtë të z. Mustafa ishte Suneta - s'e shqiptoj dot

18 DËSHMITARJA: Shyrete.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Sureta Kukançi. Dhe pastaj më vonë ju thatë se s'e mbani mend
21 kush ishte. Po shikoj që po qeshni. Ka ndonjë gjë për të
22 qeshur

23 DËSHMITARJA: Jo. E kam thënë Shyhrete Gosalci dhe e kam
24 shkru me laps. E shikon fotografinë ma pastaj kur e kam definu
25 me laps. Shyhrete Gosalci dhe e kam definu me laps. E kam

1 shkru që e njoh. Mund ta kthesh edhe njëherë ku është e
2 definume.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Flasim për personin në të djathtë të z. Mustafa?

5 DËSHMITARJA: Po.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund

7 ta bëj atë. Pra, personi në të djathtë të z. Mustafa. Po të

8 shikojmë fotografinë?

9 DËSHMITARJA: A mund ta definoj?

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po të

11 lutem, shënojeni dhe njëherë. Mund ta rrethoni, ju lutem, ta

12 qarkoni. Mirë.

13 Kjo ishte për qartësim. Se mendoj se s'e kisha menduar

14 mirë. E dëgjova njëherë që thatë ja dinit emrin, pastaj e

15 kuptova sikur herën tjetër thatë që s'e mbanit mend. Po tani

16 është e qartë. Mund ta ruajmë në këtë formë fotografinë.

17 Mirë do bëjmë një pushim tani 15 minuta.

18 Znj. Dëshmitare, do të takohemi në orën 14.50. Do ju

19 shoqërojnë jashtë sallës së gjyqit tani nga Asistentja e

20 Gjykatës.

21 [Dëshmitarja përfundon dëshminë]

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të

23 takohemi për 15 minuta.

24 --- Pauza fillon në orën 14.54

25 --- Seanca rifillon në orën 15.11

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

2 Asistente e sallës, ju lutem sillni Dëshmitaren.

3 Ndërkohë konstatoj se të gjitha ekipet janë me të njëjtën
4 përbërje si përpara pushimit. E thashë këtë për
5 procesverbalin.

6 [Dëshmitarja vijon dëshminë]

7 Mirë se u rikthyer znj. Dëshmitare.

8 DËSHMITARJA: Mirë se ju gjeta.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
10 Prokuror ju jap fjalën për pyetjet që ju kanë mbetur.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit shumë, të nderuar
12 Gjykatës.

13 Mirë se u rikthyer znj. Canolli.

14 Py. Dëshiroj t'ju bëj disa pyetje lidhur me qëndrimin tuaj në
15 Zllash.

16 Sot, më herët, dëshmuat se jeni dalë në Zllash më 16
17 prill 1999 dhe jeni larguar prej aty më 20 prill, a është e
18 saktë kjo?

19 Py. Me 21.

20 Py. Me 21. Ju kërkoj ndjesë. Është gabim im. Keni shumë të
21 drejtë.

22 Është në faqen 42 rreshtat 9 deri 15 të transkriptit sot.
23 Kjo ishte hera e parë që ishit në Zllash?

24 Pë. Po

25 Py. A jeni kthyer më pas në Zllash, pasi jeni larguar me datë

1 21 prill 1999?

2 Pë. Pas kthimit nga Majaci jemi ndalë në Sharbanë. Kur ka
3 fillu ofensiva e Sharbanit, kemi shku në Zllash po kemi shku
4 me një shtëpi tjetër. Kemi qëndru shumë pak. Pronari ka qenë
5 me emrin Sahit. Pastaj deri në fund të luftës, prapë në
6 Sharbanë.

7 Py. Si quhej ky person, pronari i shtëpisë?

8 Pë. Plaku e ka pasë emrin Sahit. Por nuk e di në cilën pjesë
9 të Zllashit ka qenë shtëpia.

10 Py. Por nuk ishte i njëjti vend ku kishit qëndruar ju më
11 përpara?

12 Pë. Jo. Në atë pjesë asnjëherë nuk kam qenë.

13 Py. Pas 21 prillit 1999, ju nuk u kthyet më kurrë në atë vend
14 të Zllashit, kështu?

15 Pë. Jo.

16 Py. Thatë sot dhe e kemi në faqen 38, rreshtat 23 dhe 24, dhe
17 në faqen 39, rreshti 23 se keni qëndruar në atë shtëpi, vetëm
18 dy ditë. A është kështu?

19 Pë. Datën 16. Dy ditë kam qëndru brenda. 16 edhe 17 jam
20 përgatitur data 18 kanë fillu bombardimet, domethënë
21 granatimet e forcave serbe. Edhe me datën 19 kam qëndru aty.
22 Me datën 20 kemi qëndru, ka qenë një mal shumë afër
23 vendbanimit, aty kemi ndejt në ambient të hapur me krejt të
24 plagosurit. Natën e 20-isht, 20 prillit.

25 Py. Ju kuptoj. Për të bërë një përmbledhje tani. Në atë

1 ndërtesë ju qëndruar me 16 edhe 17 prill. Kështu?

2 Pë. 16, 17 - jo për katër ditë po i bie. Por, 16 dhe 17 kam
3 pas punë veç brenda. Me i bë do punë që mu kanë dashtë mu për
4 shëndetësinë. Me klasifiku do barna. Do të thotë dy ditë s'kam
5 pasë mundësi me dalë jashtë. Kam ndejt veç brenda.

6 Py. Më 18 filloi granatimi. Thatë që u larguat në një moment.
7 Kështu?

8 Pë. Kam shku deri në kuzhinë kam marrë burrë. Se dy ditë më
9 kanë pru bukë [e pakuptueshme], me 18 kam shku e marrë vetë.

10 Py. Ku ndodhej kuzhina?

11 Pë. Shumë afër pjesës - ka qenë një objekt afër saj, po është
12 objekt ma i vjetër. Një herë në pjesën pak ma poshtë.

13 Py. Dhe nuk ishte ndërtesa që ju treguam sot në një moment të
14 caktuar. Ishte një ndërtesë tjetër, apo jo?

15 Pë. Sigurisht ajo fotografia është bërë pas shkatërrimit të
16 ambientit ajo pjesë nuk është. Po shihet siguri -- po nuk
17 është ajo pjesë e kuzhinës ku ka ekzistuar kuzhina. Veç aty afër
18 ka qenë.

19 Py. Pra, ishte brenda këtij kompleksi kjo ndërtesë, por jo në
20 fotografinë që jua treguan sot. Këtë po thoni?

21 Pë. Unë e bëra shigjetën aty nuk është objekti po ka qenë
22 afër, afër atij objektit ka qenë një ndërtesë më e vjetër.

23 Sigurisht që kur është bërë ajo fotografi ajo ka qenë e
24 shkatërrime, nuk po shihet që është më.

25 Py. Ju kuptoj. Një herë apo më shumë se një herë shkuat në

1 atë kuzhinë?

2 Pë. Veç me të 18 e kemi marrë bukën. Masnej kemi hëngër ç'ka
3 kemi mujt, ma s'kemi mujt as me përgatitë.

4 Py. Por atë ditë kur shkuat në kuzhinë, u kthyet pastaj në
5 atë vendin ku qëndronit përpara, ku po kujdeseshit për
6 plagosurit?

7 Pë. Po. Se kisha ende punë për të bërë.

8 Py. Nga dëshmia juaj këtu sot kuptoj se vëmendja juaj, pra
9 përqendrimi i punës tuaj në Zllash ishte kryesisht tek të
10 plagosurit. Kështu është?

11 Pë. Po.

12 Py. Sot, më herët siç e kemi në faqen 39, rreshti 24, 25, ju
13 dëshmuat se nuk po lëviznit përreth aty nëpër atë kompleksin
14 ku po qëndronit. Kështu është?

15 Pë. Jo. S'kam pasë mundësi kam pasë shumë punë.

16 Py. E kuptoj. Më herët kur po ju bënte pyetjen kolegu im i
17 nderuar, thatë se nuk dëgjuat ndonjë zhurmë se mos -- pra nuk
18 dëgjuat që dikush po keqtrajtohej apo nuk dinit që dikush në
19 Zllash po mbahej i ndaluar. Por, kur gjatë të gjithë kohës,
20 apo pjesën më të madhe të kohës, keni qenë në atë dhomë dhe
21 jeni kujdesur për të plagosurit duke përqendruar vëmendjen tek
22 këta, pastaj filloi granatimi dhe u larguar, nga mund ta dinit
23 ju se nuk ka pasur asnjë të ndaluar në Zllash?

24 Pë. Nuk kam dëgjuar nga askush. Se s'kam parë diçka. Nuk kam
25 vërejt diçka e dyshimtë, krejt kanë lëvizur lirshëm nëpër

1 oborr.

2 Py. Po a mund ta përjashtoni ju mundësinë që në ndërtesa të
3 cilat ju vetë nuk i keni vizitoni, a mund ta përjashtoni ju
4 mundësinë se mund të kishte aty të ndaluar?

5 Pë. Nuk besoj se ka pasë. Ju thashë edhe ma herët, aty ka
6 pasë edhe familje, gra me fëmijë.

7 Py. Unë e kisha ndryshe pyetjen: A mund të përjashtoni ju
8 mundësinë që në ndërtesat në të cilat ju vetë nuk i keni
9 vizuar mund të ketë pasur të ndaluar? Këtë mundësi ju mund ta
10 përjashtoni?

11 Pë. Nuk besoj që ka pasur. Nuk kam pa diçka. Diçka që nuk e
12 kam pa unë nuk muj as me thënë ka pasë ose nuk ka pasë. Diçka
13 që s'e kam ni nuk e kam ni.

14 Py. Ndërtesat të cilat jua tregoi Mbrojtja sot dhe ju thatë
15 në fillim "nuk më kujtohen" unë e kuptoj, me sa kuptoj unë, ju
16 nuk keni qenë në atë ndërtesa. Nga mund ta dinit ju, nga mund
17 ta dini pra, që aty ka pasur ose nuk ka pasur persona të
18 ndaluar. Mund ta thoshit ju këtë me siguri?

19 Pë. Këto objekte nuk ju kam kushtu rëndësi se kanë qenë
20 objekte gati të shkatërrume, objekte të vjetra. S'ka pasë
21 mundësi që diçka me jetu aty. Në oborr ne as kafshë shtëpiake
22 s'kemi pasë që me mbajt diçka në ato objekte. S'kam vërejt
23 diçka.

24 Py. Po, por ju nuk ishit aty. Nga mund ta dinit ju? Pyetje e
25 thjeshtë.

1 Pë. Thashë që nuk e di. Nuk e imagjinoj që ka pasë diçka.
2 Sipas imagjinatës teme, nuk është që ka pas diçka. Ditën kur
3 kam shku, kam shku lirshëm. Në oborr ushtarët kanë qarkullu
4 lirshëm. Fëmija e z. Fatmir Humollit dy-tri herë kanë ardhë te
5 dhoma ime. Do të thotë që kanë qarkullu lirshëm. Kjo është
6 përgjigja. S'besoj që ka pasë diçka.

7 Py. Por kjo mbështetet në atë ç'ka besoni dhe jo në atë për
8 të cilën jeni e sigurt që aty nuk është mbajtur askush,
9 kështu?

10 Pë. Unë nuk kam pa, nuk kam dëgju.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po a
12 i keni kontrolluar të gjitha ndërtesat ju vetë?

13 DËSHMITARJA: Jo, znj. Gjykatëse. Unë në atë pjesë kam
14 pasë shumë punë. Ju thashë dy ditë nuk kam lëviz dot. Në 18
15 kanë fillu granatimet. As më ka shku mendja me shku në ato
16 objekte ose në objekte të tjera. Tërë kohën kam përgatit
17 fasha, instrumentet na u ka dasht me i zi në shporet. Do të
18 thotë nuk kemi pasë asnjë send që na kryen punë mjekësore.
19 Krejt është dasht me i planifiku vetë edhe me i ba. Mos me
20 qenë ndihma e ushtarëve, vetë s'kisha mujt me mbërrite.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Faleminderit.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]:

24 Py. Pra. Znj. Canolli, ju nuk i kontrolluat të gjithat
25 ndërtesat, nuk i vizituar të gjitha. Ju qëndruat pjesën më të

1 madhe të kohës brenda asaj dhome. Kujdeseshit për të
2 plagosurit. Ishte një situatë shumë dramatike dhe e stresuar,
3 ishin shumë njerëz që kishin nevojë për ndihmë dhe po na thoni
4 se besoni se askush nuk është mbajtur aty. Po këtë nuk mund ta
5 thoni me siguri, apo jo?

6 Pë. Kjo ju nbetet juve me e thënë fjalën përfundimtare. Unë
7 sot kam ardhur me dhënë dëshminë teme aq sa di aq sa kam parë,
8 jo diçka që s'kam pa.

9 Py. Po. Pyetja ime është e fundit.

10 Ju nuk jeni e sigurt nëse aty janë mbajtur apo jo të
11 ndaluar njerëz. A është e saktë kjo që thashë?

12 Pë. S'mund të sigurohem me diçka që e kam pa ose nuk e kam
13 pa. Fjala ime, përgjigja ime përfundimet është, nuk e di. Nuk
14 kam pa diçka që kam mujt me hi në dyshime.

15 Py. Në rregull. Mjafton si përgjigje. Pak më herët sot na
16 thatë s ju përdorni rrjetet sociale dhe përmendet Facebook-un,
17 a është kështu?

18 Pë. Po.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshiroj
20 që të tregoj shumë shkurt disa postime të Facebook-ut dhe
21 dëshiroj t'i bëj disa pyetje Dëshmitares.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
23 të vazhdoni z. Prokuror.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Znj. Sekretare, është dokumenti
25 me numër SPOE00325261. Me numrin përkatës ET, në fund.

1 Py. Znj. Canolli, ky është postimi i Facebook-ut i publikuar
2 nga Brahim Mehmetaj, ndryshe i njohur me emrin Bimi. Dhe kjo
3 është një fotografi ku është, ku ka dalë ai me Salih Mustafën
4 në aeroport, kur ky po nisej në Hagë për t'u intervistuar si i
5 dyshuar.

6 A keni komentuar ju, keni bërë ndonjë koment në këtë
7 postim në Facebook të Brahim Mehmetajt?

8 Pë. Nuk më kujtohet. Ndoshta e kam pëlqy, por është kohë e
9 gjatë. Ndoshta e kam shkru "liri", ndoshta nuk e di. Nuk po më
10 kujtohet. S'e kam kontrollu.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mund të
12 tregoj pikërisht se çfarë ka postuar Dëshmitarja me lejen
13 tuaj.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
15 patjetër.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit. Ky dokument që
17 dëshiroj të tregoj tani në ekran është me numër SPOE00325266.
18 Py. Siç e shihni, Ibadete Canolli-Kaçiu ka një grusht të
19 ngritur, diku këtu nga fundi i faqes. Çfarë keni dashur të
20 shprehni me këtë grusht të ngritur këtu në këtë postim?

21 Pë. Këtë e kemi shprehje që "qëndro i fortë". Zakonisht e
22 përdorim diçka për fortësi, që me qëndru i fortë z. Mustafa.
23 Asgjë tjetër.

24 Py. Kujt keni dashur t'i thoni "qëndro i fortë"?

25 Pë. Po, ne kemi pasë idealin e përbashkët, luftën për liri.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Ibadete Canolli-Kaçiu (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk

Faqe 105

1 Do të thotë unë z. Salih Mustafa i kam thënë që me qëndru i
2 fortë, me u përballë me çdo sfidë dhe në fund sigurisht
3 drejtësia do ta bëjë të vetën.

4 Py. A mos ka qenë kjo -- çfarë keni dashur të shprehni me
5 këtë, përveç kësaj "qëndro i fortë"? Keni dashur që të tregoni
6 edhe mbështetje për Salih Mustafa, me ish-komandantin tuaj të
7 BIA?

8 Pë. Po sigurisht që mbështetje morale.

9 Py. Ju kuptoj.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshiroj
11 të tregoj një tjetër postim në Facebook.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
13 patjetër.

14 Znj. Sekretare, ju ndërkohë kërkoj që të nxirrni
15 dokumentin me numrin SPOE00325372, me numrin përkatës, por me
16 ET në fund.

17 Py. Është një postim në Facebook i publikuar nga Brahim
18 Mehmetaj, ndryshe i quajtur me emrin Bimi me datë 28 tetor të
19 vitit 2022.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mos doni t'jua përsëris. Po
21 është SPOE00325372.

22 Më falni, më duket se ka një numër disi më ndryshe. Është
23 27, pra - 125327. Ju kërkoj ndjesë, të nderuar Gjykatës. Ka
24 shumë fotografi sot.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po në

1 listën që na keni dhënë e shoh numrin e saktë.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Znj. Canolli, ju kujtohet ky
3 postim në Facebook i Brahim Mehmetajt, Bimit?
4 Pë. Paskan kalu më shumë se dy vjet. Ndoshta e kam pëlqy,
5 ndoshta e kam komentu. Zakonisht diçka që më pëlqen e pëlqej,
6 por jo çdo postim që e bëjnë.

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshiroj
8 t'i tregoj Dëshmitares dhe komentin që ka vendosur këtu.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Patjetër.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Numër 00325377. Është edhe në
12 versionin anglisht.

13 Py. Mund të shihni në mes të faqes, komentin i cili në
14 anglisht është komenti juaj, pra, "Gjithmonë në shërbim të
15 atdheut, drejtësi për çlirimtarët".

16 Ju kujtohet që ta keni postuar këtë?

17 Pë. Po, është këtu fotografia jeme. Është komenti jem.

18 Py. Çfarë keni dashur të shprehni me këtë koment?

19 Pë. Gjithmonë në shërbim të atdheut, ne si popull e kemi
20 shprehi që jetën ja kemi borxh atdheut. Në çfarëdo rrethane,
21 jetën ja kemi borxh atdheut. Këtu do të thotë, Cali është --
22 z. Mustafa është me uniformë ushtarake. Do të thotë kjo pjesë
23 e ka këtë kuptim. Ndërsa "drejtësi për çlirimtarët",
24 përfundimi i këtij procesi gjyqësor në mënyrë sa më të drejtë.

25 Py. Keni dashur të shprehni mbështetjen tuaj për Salih

1 Mustafa, ish-komandantin tuaj në BIA?

2 Pë. Po, sigurisht mbështetje morale.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, fotografia
4 e fundit nëse mundet.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Patjetër.

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Znj. Prokurore, kjo është me
8 numër 00325394. Versioni në anglisht, përkthimi pra në
9 anglisht gjithashtu.

10 Py. Është një postim në Facebook në profilin e Brahim
11 Mehmetajt, ndryshe i njohur me emrin Bimi, i datës 1 janar
12 2021

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A mund ta kontrollojë
14 edhe një herë Prokurori numrin?

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po SPOE00325394, besoj

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mos
17 vallë e ka në fund 329?

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mundet, mundet të jetë kjo.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Se
20 unë në listën e materialeve që do të përdorni ju në
21 kundrapyetje është një koment në Facebook nga -- jo postim në
22 Facebook nga profili i Brahim Mehmetajt, Bimit.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po kjo mund të jetë. Mund të
24 jetë 105329 dhe 320. 330 më falni. Është versioni në anglisht
25 gjithashtu. Kjo është, faleminderit për ndihmën, e nderuar

1 Gjykatëse.

2 Py. Ju kujtohet ky postim?

3 Pë. Po zakonisht është shpërnda kjo bluza me fotografinë e z.
4 Mustafa. Është shpërndarë zakonisht krejt përkrahësve të tij
5 që e kanë përkrahë moralisht.

6 Py. Keni komentuar ju në këtë postim?

7 Pë. Ndoshta kam komentu. Nuk jam e sigurt. Mundesh ta çok ma
8 poshtë komentin.

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, shumë
10 shkurt të tregoj komentin dhe pastaj mund të vazhdoj më tutje.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Patjetër.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Komenti është me numër
14 SPOE00325404 dhe përkthimit përkatës në anglisht.

15 Py. Pra, komenti juaj është "Gëzuar ditëlindjen, urime
16 ditëlindjen".

17 Pë. Mendoj ka qenë ditëlindja e Salih Mustafës, Bimi e ka
18 postu dhe ja kam uruar ditëlindjen nga largësia.

19 Py. E kuptoj. Faleminderit shumë.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund ta heqim këtë fotografi
21 nga ekрани.

22 Py. Zonja Canolli, gjatë luftës keni mbajtur shënime, në
23 ndonjë formë?

24 Pë. E kam pasë një fletore të vogël. Kam shkru veç -- jo
25 përjetimet e luftës, emocionet e mia ndaj familjes. Veç është

1 shkrime emocionale, jo data.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatëste, jo para
3 se të kalojmë te kjo.

4 Py. A keni dhënë ndonjë intervistë në vitin 2001, ndonjë
5 medie për luftën? Në televizion a? 2021.

6 Pë. 2021? Po.

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dëshiroj, më falni, që të
8 nxjerrim në ekran, të nderuar Gjykatës, një klip shumë të
9 shkurtër, pra një pjesë shumë të shkurtër të intervistës që
10 Ibadete Canolli-Kaçiu i kish postuar në kanalin YouTube të një
11 televizioni, 18 shkurt 2021.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është
13 video publike?

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, publike.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sepse
16 imazh - pamjen nuk do të duken, ama zëri do të dëgjohet, ama
17 po të jetë publike s'ka problem, po thjeshtë dua që të
18 konfirmoj.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Është video publike është
20 publikuar në YouTube.

21 Nuk kam ndërmend që ta shfaqim, por thjesht të shikojmë
22 në disa moment të asaj video që shfaq pikërisht ato gjëra për
23 të cilat i bëra pyetje Dëshmitares. Pikërisht këtë fletore që
24 ajo vetë e ceku.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nejse

1 edhe në qoftë se do të dalë kolona zanore nuk është
2 problematike, se është publike.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo s'është problem.

4 Znj. Sekretare nuk është nevoja që ta shfaqim videon por
5 mbase mund të kalonim tek ky moment, 00:45 deri në 00:46. S'ka
6 nevojë vetëm që të duket pamja.

7 Pra kjo është, kjo është pamja. Pastaj mund të kalojmë
8 menjëherë tek momenti 1:12 dhe 1:15 për ta treguar shkurt.

9 [Ekzekutohet videoklipi]

10 Dhe pastaj 1:51 dhe 1.53.

11 [Ekzekutohet videoklipi]

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]:

13 Py. A është kjo intervista për të cilën flisnim?

14 Pë. Po.

15 Py. Pra në këtë video disa herë ne pamë disa -- pamë një
16 bllok të vogël ngjyrë të gjelbër. Për këtë bllok po flisnit
17 ju?

18 Pë. Po, për këtë bllok po flas.

19 Py. Po ashtu mund të shihnim pak sekonda më parë ishte një
20 shënim 24 mars 1999. E patë?

21 Pë. Do të thotë prej ditës së bombardimeve emocionet e mia
22 personale i kam përshkru aty. Gjatë kohës së bombardimeve jo
23 çdo ditë veç kur më ka ardhë mundësia me shkru, këtë bllok e
24 kam pasë çdo herë me vete.

25 Py. A keni shënuar atje disa ngjarje të rëndësishme, datat

1 kur ndodhën apo ndonjë përshkrim të shkurtë?

2 Pë. Jo çdo gjë. Disa emocione, pas dy-tri javëve kam pasë

3 mundësi me shkru. Pas pesë-gjashtë ditëve i kam përmbledhë

4 diçka emocionet, në momentin kur jam ndjerë shpirtërisht keq.

5 Në momentin kur më ka mungu familja, kur më ka mungu, çdo herë

6 e kam përshkru aty. E kam mbaj gjithmonë me vete që me e pasë

7 si një kujtim të mirë.

8 Py. Pra, në qoftë se e kuptoj si duhet ju merrnit shënime

9 gjatë periudhës së luftës? Hidhnit shënime diku?

10 Pë. Po, herë pas here.

11 Py. Edhe në vitin 1999, në prill të vitit 1999?

12 Pë. Jo ato ditë jo, derisa kanë kalu. Ato ditët e vështira

13 s'kam pasë mundësi me shkru. Kam shkru në fillimin e prillit

14 kur unë jam vendos me familjen aty, mandej pas një kohe të

15 gjatë kam përshkru që tash nuk jam më me familjen. Po më

16 mungojnë. Tash jam pjesë e ushtrisë. Krejt përjetime

17 personale.

18 Py. A keni shkruar ndonjë gjë atje për z. Salih Mustafën,

19 komandantin e njësitit tuaj? E njësitit BIA?

20 Pë. Jo nuk kam shku. E kam përshkru veç një herë me Isa

21 Kastratin. E kemi pasë një farë gjarpri të plastikës, ja pata

22 gju me mendu që është. Ai tha [e pakuptueshme] se ka qenë një

23 emocion i mirë. Ka mendu që ka qenë gjarpri i gjallë. Atë

24 pjesë e kam spjegu se kam pasë qejf gjithmonë me mu ngulit në

25 mendje mos me e harru atë pjesë. Edhe kam edhe gjatë

1 intervistës e kam spjegu këtë pjesë.

2 Py. A keni shënuar ndonjë gjë në atë bllok lidhur me ndonjë
3 ngjarje që ndodhi në Zllash në prill të vitit 1999?

4 Pë. Jo, përveç kanë ndodhur luftime, kanë ndodhur ofensiva,
5 gjendja është [e pakuptueshme]. Po jo diçka ça i përket jetës
6 ushtarake s'kam përshkru. Janë kanë veç emocionet e mia,
7 përjetimet e mia personale.

8 Py. Po aso kohe me sa kujtoj unë nga dëshmia juaj e sotme,
9 koha periudha në Zllash sidomos evakuimi, koha që keni
10 qëndruar me të plagosurit që ka qenë një moment i shënuar në
11 jetën tuaj, a s'keni reflektuar asgjë prej kësaj në bllokun
12 tuaj prej kësaj periudhe? Dhe nëse jo, atëherë pse nuk kemi
13 shënuar asgjë për këtë periudhë?

14 Pë. Po nuk ka pasë mundësi derisa sa jemi kthi në Sharbanë
15 nuk kam shkru kurr gjë. Në Sharbanë i kam përshkru në pika të
16 shkurtra ndryshimet emotive, koha sa ka kalu, ka kaluar dy
17 javë, tri javë që s'kam shkru. Jo, atë ditë s'kam pasë mundësi
18 me marrë fletore. Megjithëse e kam pasë çdo herë qejf, por nuk
19 kam pasë mundësi me u fokusu në fletore kur ka pasë punë më të
20 mëdhaja me u bë.

21 Py. A nuk shkrove në bllok pasi ndodhën ngjarjet e prillit
22 1999? Nuk shënuat pas prillit?

23 Pë. Ky nuk ka qenë ditar i luftës, i përjetimeve të luftës.
24 Ka qenë ditar emocional kur unë kam pas nevojë me përshkru
25 ndjenjat e mia emocionale. Edhe unë jam konë njeri, me kanë

- 1 munguar familja, më kanë munguar njerëzit e dashur ato
2 përjetime i kam shkruar aty. Edhe sot, shpesh herë kur nuk e
3 ndjej veten time apo diçka [e pakuptueshme] ose dikund i
4 shkruaj dy-tri fjalë që me mbet një kujtim emocional. Nuk kam
5 mbajt ditar të luftës.
- 6 Py. Kjo mund të jetë e vërtetë, megjithatë siç mund ta shihni
7 në ekran ju keni shënuar në fund të faqes datën 24 mars 1999,
8 që është edhe data e bombardimeve të NATO-s. Fillimi i
9 bombardimit. Kështu që disa fakte i keni hedhur aty që në fakt
10 kanë lidhje me atë periudhë, apo jo?
- 11 Pë. Po prej asaj date gjendja emocionale e imja ka ndryshue.
12 Do të thotë prej asaj date ne kemi fillu -- lufta në Prishtinë
13 ka qenë luftë frontale, do të thotë, lufta në të gjitha anët,
14 po prej asaj dite unë më nuk kam pasë lirinë e lëvizjes. Ato
15 përjetime të miat kanë qenë, jo të ushtrisë. Prej asaj dite
16 unë më nuk kam qenë lëvizshëm në qytet. Asnjëherë më nuk kam
17 dalë më lirshëm derisa ka përfundu lufta në qytetin e
18 Prishtinës.
- 19 Py. Gjatë intervistës televizive, online më saktë, keni
20 treguar, keni shfaqur edhe këtë bllokun. E keni pasur bllokun
21 edhe gjatë intervistës me Mbrojtjen?
- 22 Pë. Jo.
- 23 Py. A u tregove, a u the që kishe ato shënimet e asaj kohe? U
24 ke thënë gjë Mbrojtjes.
- 25 Pë. As nuk më kanë pyet as u kam thënë. Edhe kjo ka qenë

1 diçka shumë personale aq as fëmijët e mi, as burri jem nuk i
2 ka lexu.

3 Py. Mos e keni marrë gjë me vete rastësisht këtu në Gjykatë
4 në Hagë?

5 Pë. Jo e kam në uniformën ushtarake, aty e kam vendosur. Atë
6 uniformën [e pakuptueshme] vetëm atë të renë e kam aty, e ruaj
7 se nuk e kam me vedit.

8 Py. Ku është tani pra? Është tek uniforma në shtëpinë tuaj në
9 Kosovë? Ku është tani ky ditari?

10 Pë. Mendoj që diku nëpër shtëpi, nuk jam e sigurt.

11 Py. Keni ndonjë kundërshtim t'ja jepnit këtë bllok
12 Prokurorisë apo Gjykatës ta fotokopjojë nëse është e
13 nevojshme?

14 Pë. Ju kërkoj falje. Është diçka shumë personale. Emocionet
15 e mia nuk kam qejf me ja shpreh kurrkujt. Nuk është diçka që
16 ka të bëjë me luftën, është me ndjenjat e mia personale.

17 Py. E kuptoj këtë. Megjithatë në këtë intervistën online që e
18 ka parë gjithë bota ju keni shfletuar faqet e këtij bllokut.
19 Në qoftë se ishte kaq personale, atëherë pse ja keni treguar
20 gjysmës së botës?

21 Pë. Po veç unë i kam thënë gazetarëve që mos -- shkrimet mos
22 me u publiku, veç me e pa.

23 Py. Po megjithatë ju mund të shihni që disa nga shënimet aty
24 janë të dukshme. Është emri yt. Pashë emrin Skifter. Pashë një
25 numër telefoni. Mund të shihja edhe atë datën 24 mars 1999?

1 Pë. Është fleta e parë e bllokut.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Kam edhe tre pyetje edhe do ta
3 mbyllim, të nderuar Gjykatës.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Vazhdoni.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]:

7 Py. Më lejoni të ndryshoj pak temën. Sot na thatë, dëshmuat
8 se kur shkuat në Zllash në prill të vitit 1999, më 16 prill,
9 patë Isa Kastratin që ishte -- ju thatë që po dëgjonte lajmet
10 kur e patë ju. Kështu?

11 Pë. Po.

12 Py. Faqja 41 më falni, rreshtat 20-22 të transkriptit të
13 sotshëm. A ju kujtohet se me çfarë pajisje po i shihte, ku po
14 i dëgjonte këto lajme?

15 Pë. Pa pas një transistor të vogël me antenë, të cilin e
16 afronte te veshi, tërë kohën e ka mbajt afër. Në atë kohë ora
17 gjashtë ose ka qenë Deutsche Welle ose ka qenë Zëri i
18 Amerikës. Po shumë afër veshit, një transistor me bateri e ka
19 mbajt.

20 Py. Pra kishte një transistor me bateri apo ishte i lidhur me
21 një bateri të jashtme?

22 Pë. Jo, jo transistor i vogël me një bateri me antenë që ka
23 shkonte e ka majte mbas vedit.

24 Py. Në dëshminë tuaj sot në faqen 48, rreshti 2, ju po ashtu
25 thatë që gjatë kohës që ishit në Zllash përdoreshin edhe

1 bateritë e makinave, apo jo?

2 Pë. Po.

3 Py. Për çfarë përdoreshin? Për t'i dhënë rrymë kujt, cilave
4 pajisje? Si përdoreshin më saktë?

5 Pë. Kam pasë një dritë, nuk e -- ka qenë i lidhur me një
6 dritë të cilën ma ka mbajtur te plagët, gjatë pastrimit të
7 plagëve në mbrëmje ose asi ma ka mbajtur me dritë afër plagës që
8 me pasë ndriçim ma të madh sesa atë lloj të qirijve që i kemi
9 përdor. Për atë arsye është përdor.

10 Py. Pra, bateritë ndihmonin për rrymë? Për të - për të lidhur
11 me llamba për të ndriçuar?

12 Pë. Po [e padëgjueshme]. Për të lidhur me llambën po.

13 Py. E kuptoj.

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më lejoni
15 të konsultohem pak me ekipin dhe besoj se do ta mbyll shumë
16 shpejt.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Vazhdoni.

19 [Prokurori i Specializuar këshillohet]

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kemi
21 pyetje të tjera.

22 Znj. Canolli, faleminderit.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Faleminderit.

25 Mirë atëherë. Tani të flasim pak për planifikimin.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Ibadete Canolli-Kaçiu (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 117

1 Mbrojtësja e Viktimave, a keni ju pyetje për Dëshmitaren?

2 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës, nuk
3 kemi.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Avokat, po ju?

6 Z. SHALA: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Faleminderit.

9 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
11 Dëshmitare nuk ka pyetje as nga Mbrojtja, Prokuroria dhe as
12 nga Mbrojtësja e Viktimave. Megjithatë ka disa pyetje nga
13 Trupi Gjykses. Kështu që do t'i jap fjalën kolegut tim t'ju
14 bëjë disa pyetje të mëtejshme të cilat nuk janë shumë, por që
15 besoj se do na ndihmojmë të qartësojmë disa aspekte, disa nga
16 aspektet e dëshmisë tuaj sot edhe si dhe të deklaratave tuaja
17 të mëparshme. Kështu që duroni edhe pak ju lutem. Tani po ja
18 jap fjalën kolegut tim në të majtën time.

19 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit znj.
20 Kryegjykatëse.

21 Pyetje nga Trupi Gjykses:

22 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Pikësëpari sot në faqen 38,
23 rreshtat 13 dhe 14 kur shkuat tek vendi që qëndruat nga data
24 16 deri më 21 prill 1999, ju thatë:

25 "Pronari i shtëpisë u raportonte, u raportoi atyre se

1 isha atje..."

2 A mund të na e qartësoni kush ishte pronari i shtëpisë?

3 Py. Pronari, siç janë konë më herët, në fshatin Mramor, me
4 atë kam kontakt dy ditë më herë dhe i kam thënë sa është
5 rruga larg me shku deri në Zllash. Ai ka qenë Afrim Gashi. E
6 kupton se po kam qejf me shku atje. Atëherë ai më ka thënë unë
7 bisedoj me dikënd me ushtarëve, i ka kontakt kanë ardhur tre
8 ushtarë më kanë marrë dhe më kanë dërgu në Zllash. Pronari i
9 shtëpisë ku kanë qëndru familja ime dhe unë gjatë kohës para
10 se me shku në Zllash unë. Për atë pronar e kam pasë fjalën.

11 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Ah pra kur shkuat në Zllash,
12 s'kishte pronar shtëpie në Zllash, pra nuk -- dhe nuk i
13 raportoje askujt. Kështu është apo jo?

14 Pë. Po ashtu. Mirë e kuptove tash.

15 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. E qartë.

16 Pak minuta më parë na shpjegove për granatimet për vendin
17 ku ishit ju në Zllash i cili filloi më datë 18. Çfarë ndodhi
18 më datë 19?

19 Pë. Me datën 18 kanë fillu granatimet e mëdha me datën 19 ka
20 pasë granatime edhe luftë frontale. Me datën 19 kanë fillu me
21 ardhë numër i madh të plagosurve përveç ushtarëve edhe civilë.
22 Data 19 ka qenë data më e tmerrshme e gjithë atyre
23 përjetimeve.

24 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Po çfarë ndodhi me datën 19.
25 Çfarë ju ndodhi ju. Qëndrove aty ku ishte apo u zhvendose, në

1 vendin ku po qëndroje?

2 Pë. Jo aty kam qëndru, përveç 10 minuta deri ku kam tërhek
3 një të plagosur. Po nuk jam e sigurt ka qenë data 19 apo 20
4 kur e kam tërhek një të plagosur dikun 500 metra larg objektit
5 ka qenë. Kam shkue e kam marrë një të plagosur edhe e kam
6 tërhek lart. Asnjëherë nuk jam largu.

7 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Mirë pra, me 19 kishte
8 granatime por granatimet nuk ndodhën tek vendi ku qëndronit
9 ju. Prandaj po qëndronit ende aty, apo jo?

10 Pë. Po me datën, në mbrëmjen e 19 kanë ardhë grantimet kanë
11 filluar granatimet me afruar. Datën 20 ka pasë granatime edhe
12 në atë pjesën ku kam qenë unë edhe natën e datës 20 kemi
13 qëndruar në atë malin afër domethënë në ambient të hapur. Kemi
14 qëndruar me krejt të plagosurit se granatat i kanë ruajt
15 drunjt jo drejtpërsëdrejti neve.

16 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Pra granatimi
17 filloi të afrohej në datën 20 tek vendi ku ishit ju. Ju dolët
18 por qëndruat afër vendndodhjes dhe pastaj më 21 u larguat për
19 në Majac, apo jo?

20 Pë. Po në mëngjesin e 21 kemi vazhdu rrugën me i tërhek krejt
21 të plagosurit në Majac.

22 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Pra, hera e fundit që keni
23 parë vendndodhjen ku keni qëndruar ka qenë më 20 prill në
24 mbrëmje, apo jo?

25 Pë. Po.

1 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Më pas filluat evakuimin më
2 21 dhe nuk u kthyet më asnjëherë tek ai vend, apo u kthyet tek
3 ai vend?

4 Pë. Asnjëherë tek ai objekt nuk jam kthyer më.

5 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit.
6 Mbarova.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Faleminderit.

9 Atëherë znj. Canolli-Kaçiu. Mbërritën në fund të dëshmisë
10 tuja. Dëshiroj t'ju falënderoj për përpjekjet tuaja për
11 dëshminë tuaj para Dhomave të Specializuara. Jam e bindur që
12 do të na ndihmojë të gjejmë, të zbulojmë të vërtetën. Ju uroj
13 rrugë të mbarë dhe ju kujtoj se nuk duhet të diskutoni
14 dëshminë që keni dhënë para Dhomave të Specializuar me askënd.
15 Faleminderit edhe një herë.

16 Znj. Asistente e Gjykatës ju lutem shoqëroni znj.
17 Dëshmitare jashtë sallës së Gjyqit.

18 DËSHMITARJA: Faleminderit, kalofshi mirë.

19 [Dëshmitarja përfundon dëshminë]

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit.

22 Palët dhe Mbrojtësja e Viktimave a kanë gjë tjetër për të
23 parashtruar për të ngritur?

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Asgjë, e nderuar Gjykatëse.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Mbrojtësja e Viktimave?

2 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Në fakt nga ana praktike kemi
3 diçka për seancat që janë parashikuar për nesër. Seanca për
4 nesër dhe për 17 dhe 18 meqë është në fakt deklarata jo nën
5 betim më 19. 20. Seancat e parashikuara a do të mbahen apo jo?

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ne
7 mbaruam sot. Unë do ta thoja vetë këtë për një minutë. Nesër
8 nuk kemi seancë sepse nuk kemi më dëshmitarë për të dëgjuar
9 ndërsa për javën tjetër kemi planifikuar në fakt siç edhe e
10 thatë datën 19 paradite, vetëm paradite, në datën 20. Seancat
11 e tjera ishin vërtetë planifikuar, po ishin thjesht të
12 rezervuara si data.

13 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Pyeta këtë për të organizuar
14 udhëtimin për veten. Faleminderit.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
16 mua nuk ishte e qartë pse nuk ishte e qartë sidomos për javën
17 tjetër.

18 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Zakonisht
19 marrim një email në *Legal Workflow* që marrim edhe shpjegimet
20 çfarë është anuluar dhe mbase duke qenë se kam qenë këtu
21 gjithë ditën nuk e kam parë. Po ju faleminderit për
22 shpjegimin.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ta
24 shohim, por sigurisht Trupi Gjykes dëshiron që të gjithë ta
25 dinë se çfarë seancash janë planifikuar për javën tjetër. Por

1 për nesër sigurisht që vetëm sot në fund të ditës mund ta
2 merrje vesh. Faleminderit.

3 Avokat a ka diçka që doni të ngrini?

4 Z. SHALA: [Përkthim] JO.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Atëherë do të takohemi me datën 19 maj, në orën 09.30 për
7 deklaratën jo nën betim të të akuzuarit.

8 Seanca mbyllet.

9 --- Seanca përfundon në orën 16.01

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25